i) "Kostot Operative" do të thotë shpenzimet e arsyeshme dhe në rritje, që shkaktohen nga Sekretariati Kombëtar i EITI-t dhe MSG-ja për arsye të shpenzimeve të udhëtimit, si dhe ndonjë shpenzim tjetër të arsyeshëm të dakordësuar me Bankën, të cilat lidhen drejtpërsëdrejti me zbatimin e Projektit;

j) "Rregulloret e Prokurimit" do të thotë, për qëllimet e paragrafit 20 të shtojcës së Kushteve Standarde "Rregulloret e Prokurimit të Bankës Botërore për Përfituesit IPF", të datës nëntor 2020;

k) "Matriksi i Përgjegjësisë" do të thotë matriksi i përgjegjësisë për zbatimin e Projektit, që do të përgatitet dhe miratohet nga Përfituesi në një mënyrë të pranueshme për Bankën dhe të përmendur në seksionin 2.03, të shtojcës së kësaj Marrëveshjeje, i ndryshuar herë pas here me marrëveshje me Bankën;

l) "Kushtet Standarde" do të thotë Kushtet Standarde të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim për Financimin e Grantit të bërë nga Banka nga Fondet e Besimit", të datës 25 shkurt 2019;

m) "Trajnim" do të thotë shpenzimet (përveç shpenzimet e konsulentëve) të shkaktuara gjatë zbatimit të Projektit, bazuar në buxhetet periodike të pranuara nga Banka, për: i. shpenzime të arsyeshme për udhëtimin, akomodimin, ushqimin dhe dietat, të shkaktuara nga trajnerët dhe të trajnuarit në lidhje me trajnimin e tyre; ii. tarifat e kursit; iii. godina ku zhvillohet trajnimi/seminari dhe qiratë e pajisjeve; dhe iv. shpenzimet e përgatitjes, blerjes, riprodhimit dhe shpërndarjes së materialeve të trajnimit që ndryshe nuk mbulohen nga ky paragraf.

Neni II

Ekzekutimi i Projektit

2.01. **Objektivat dhe përshkrimi i Projektit**. Projekti ka si objektivë të mbështesë Përfituesin në ruajtjen e pajtueshmërisë së EITI-t dhe forcimin e menaxhimit transparent të sektorit të tij ekstraktues. Projekti konsiston në pjesët e mëposhtme:

Pjesa A. Mbështetja e raportimit të mbështetjes së EITI-t

Sigurimi i mbështetjes së zbatimit për ruajtjen e pajtueshmërisë së EITI-t, duke përfshirë, *ndër të tjera*: i. përgatitjen e raporteve vjetore të EITI-t; ii. përgatitjen e modeleve të reja të raportimit; iii. përmirësimin dhe ruajtjen e kadastrës së portalit të të dhënave dhe minierave të EITI-t; iv. rishikimin e legjislacionit aktual mbi raportimin për të ofruar rekomandime për përmirësimin e tij; dhe v. vlerësimin e boshllëqeve për mbështetjen e EITI-t.

Pjesa B. Shtirja e objektit të zbulimeve të informacionit të sektorit

Sigurimi i mbështetjes për përmirësimin e aksesit tek të dhënat e EITI-t, duke përfshirë, *ndër të tjera*: i. kryerjen e vlerësimeve të ndikimeve të: a) pajtueshmërisë me legjislacionin ekzistues mbi regjistrin tregtar të pronarëve përfitues (duke përfshirë përfundimin e një *roadmap*-i përkatës); b) kushtet sociale-ekonomike të industrisë së prodhimit të naftës dhe rreziqet dhe përfitimet e lidhura; dhe c) investimet e huaja për sektorin ekstraktues; ii. kryerjen e një studimi të fushëveprimit për raportimin gjinor dhe pjesëmarrjen e grave në sektorin ekstraktues, përfshirë mbështetjen për ndërtimin e kapaciteteve dhe zhvillimin e strategjisë; iii. kryerjen e një studimi të fushëveprimit për përfshirjen e sektorit të energjisë së rinovueshme (erë dhe diellore) dhe gazit në raportimin e EITI-t, duke përfshirë mbështetjen për dialogun mbi tranzicionin e energjisë; dhe iv. kryerjen e analizave të legjislacionit aktual mbi shëndetin dhe sigurinë në punë në sektorin ekstraktues.

Pjesa C. Mbështetja dhe ndërtimi i kapaciteteve

Sigurimi i mbështetjes për: i. aktivitetet e trajnimit për menaxhimin e burimeve natyrore të EITI-t në interes të stafit të Sekretariatit Kombëtar të EITI-t, anëtarëve të MSG-së, dhe aktorëve përkatës dhe pjesëmarrja në ngjarje ndërkombëtare studimore dhe udhëtime studimore për stafin e Sekretariatit Kombëtar të EITI-t dhe anëtarët e MSG-së; ii. zbatimi i strategjisë për komunikimin dhe shtrirjen e EITI-t të Përfituesit, nëpërmjet kryerjes së fushatave të mediave sociale dhe informuese; dhe iii. hartimi i një strategjie mbi angazhimin për menaxhimin e burimeve natyrore.

Pjesa D. Menaxhimi i Projektit

Mbështetje për aktivitetet e menaxhimit të Projektit, duke përfshirë monitorimin, vlerësimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen, dhe auditet e Projektit; dhe mekanizmin për trajtimin e ankesave, të gjitha nëpërmjet sigurimit të Kostove Operative dhe stafit.

2.02. **Ekzekutimi i Projektit në përgjithësi**. Përfituesi deklaron angazhimin e tij lidhur me qëllimin e Projektit. Në këtë drejtim, Përfituesi do të zbatojë Projektin nëpërmjet Sekretariatit Kombëtar të EITI-t, në përputhje me dispozitat e: a) nenit II të Kushteve Standarde; b) udhëzimeve Anti-Korrupsion; dhe c) këtij neni II.

2.03. **Angazhimet institucionale dhe të tjera**. Pa kufizim dhe në vijim të seksionit 2.02, të aneksit të kësaj Marrëveshjeje, Përfituesi merr masa që Sekretariati Kombëtar i EITI-t:

a) të caktojë kreun e Sekretariatit Kombëtar të EITI-t si një koordinator të Projektit, përgjegjës për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e Projektit;

b) jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas Datës së Hyrjes në Fuqi, të rekrutojë dhe më pas mbajë gjatë zbatimit të Projektit, një specialist për prokurimet dhe një specialist për menaxhimin financiar, të pajisur me kualifikimet, përvojën dhe termat e referencës të pranueshme për Bankën;

c) të sigurojë që Sekretariati Kombëtar i EITI-t përmbush detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe se Projekti kryhet në përputhje me këtë Marrëveshje dhe Matriksin e Përgjegjësisë, duke përcaktuar rregullat, metodat, udhëzimet dhe procedurat për kryerjen e Projektit;

d) të mos ndryshojë, pezullojë, shfuqizojë ose heqë dorë nga ndonjë dispozitë e Matriksit të Përgjegjësisë pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës. Në rast se ndonjë dispozitë e Matriksit të Përgjegjësisë është në mospërputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi; dhe

e) të sigurojë koordinimin e duhur me MSG-në për zbatimin e Projektit, dhe se MSG-ja është përgjegjëse, në koordinim me Përfituesin, për marrjen e vendimeve mbi politikat dhe sigurimin e rekomandimeve për pajtueshmërinë e aktiviteteve të Projektit me politikat e sektorit.

2.04. Standardet Mjedisore dhe Sociale

a) Përfituesi duhet dhe do të marrë masa që Sekretariati Kombëtar i EITI-t të garantojë që Projekti realizohet në përputhje me Standardet Mjedisore dhe Sociale, në një mënyrë të pranueshme për Bankën;

b) Pa u kufizuar në paragrafin 1 më sipër, Përfituesi duhet dhe do të marrë masa që Sekretariati Kombëtar i EITI-t të garantojë që Projekti zbatohet në përputhje me Planin e Angazhimit Mjedisor dhe Social ("PAMS"), në një mënyrë të pranueshme për Bankën. Për këtë qëllim, Përfituesi duhet të sigurojë që:

i. masat dhe veprimet e specifikuara në PAMS të zbatohen me kujdesin dhe efikasitetin e duhur, siç parashikohet në PAMS;

ii. ka fonde të mjaftueshme të disponueshme për të mbuluar kostot e zbatimit të PAMS-së;

iii. ruhen politikat dhe procedurat, dhe mbahet personel i kualifikuar dhe me përvojë, dhe në numra të duhur për zbatimin e PAMS-së, siç parashikohet në PAMS; dhe

iv. PAMS-ja ose ndonjë dispozitë e saj nuk ndryshohet, shfuqizohet, pezullohet ose hiqet dorë, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe me shkrim, siç specifikohet në PAMS, dhe siguron që PAMS-ja e rishikuar të zbulohet menjëherë më pas;

c) Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet PAMS-së dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi;

d) Përfituesi, duhet dhe do të marrë masa që Sekretariati Kombëtar i EITI-t të sigurojë që:

i. janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbledhur, hartuar dhe dorëzuar Bankës nëpërmjet raporteve të rregullta, me shpeshtësinë e përcaktuar në PAMS dhe menjëherë në një raport ose raporte të veçanta, nëse kërkohet nga Banka, informacion lidhur me statusin e pajtueshmërisë me PAMS-në dhe instrumentet mjedisore dhe sociale të përmendura në të, të gjitha këto raporte duhet të jenë në formë dhe në thelb të pranueshme për Bankën dhe të përcaktojnë, ndër të tjera: A) statusin e zbatimit të PAMS-së; B) kushtet, nëse ka, të cilat ndërhyjnë ose rrezikojnë të ndërhyjnë në zbatimin e PAMS-së; dhe C) masat korrigjuese dhe parandaluese të marra ose që kërkohen të merren për të trajtuar këto kushte; dhe

ii. Banka njoftohet menjëherë për çdo incident ose aksident që lidhet ose ka ndikim mbi Projektin, i cili ka ose mund të ketë efekt negativ të konsiderueshëm për mjedisin, komunitetet e prekura, publikun ose punëtorët, duke përfshirë, në përputhje me PAMS-në, instrumentet mjedisore

dhe sociale të përmendura në të dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale;

e) Përfituesi, do të krijojë brenda gjashtë (6) muajsh nga Data e Hyrjes në Fuqi, publikojë, mirëmbajë dhe përdorë një mekanizëm të aksesueshëm për zgjidhjen e ankesave për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të personave të prekur nga Projekti dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të duhura për të zgjidhur ose për të lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të tilla, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

2.05. Dokumentet; të dhënat

Gjithashtu, dhe pa kufizuar detyrimet e përcaktuara në seksionin 2.05 të Kushteve Standarde, Përfituesi duhet dhe do të marrë masa që Sekretariati Kombëtar i EITI-t të sigurojë që:

a) Të gjitha të dhënat që identifikojnë shpenzimet sipas Projektit ruhen për shtatë vjet dhe gjashtë muaj pas Datës së Mbylljes, dhe këto të dhëna përfshijnë: i. këtë Marrëveshje, të gjitha shtesat dhe çdo ndryshim lidhur me të; ii. raportet e progresit financiar dhe narrativ të Përfituesit të dorëzuar në Bankë; iii. informacionin financiar të Përfituesit lidhur me Grantin, duke përfshirë raportet e auditit, faturat dhe të dhënat e listës së pagave; iv. dokumentacionin e zbatimit të Përfituesit (duke përfshirë nënmarrëveshjet, dosjet e prokurimit, kontratat, urdhrat e blerjes); dhe v. dëshmi përkatëse mbështetëse, të përmendur në seksionin 3.04 të Kushteve Standarde; dhe

b) Përfaqësuesit e Bankës: i. mund të shqyrtojnë të gjitha të dhënat të përmendura sa më sipër në paragrafin "a"; ii. kanë ofruar të gjithë këtë informacion lidhur me këto të dhëna që mund të kërkohen herë pas here në mënyrë të arsyeshme; dhe iii. mund të zbulojnë këto të dhëna dhe informacion te donatorët.

2.05. Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi i Projektit. Përfituesi, duhet dhe do të marrë masa që Sekretariati i Kombëtar i EITI-t dorëzon në Bankë çdo Raport Projekti, jo më vonë se një muaj pas përfundimit të çdo gjashtëmujori kalendarik, që mbulon gjashtëmujorin kalendarik.

Seksioni III
Tërheqja e të Ardhurave të Grantit

3.01. Shpenzimet e arsyeshme. Përfituesi mund të tërheqë të ardhurat nga Granti në përputhje me dispozitat e: a) nenit III të Kushteve Standarde; dhe b) këtij seksioni; për të financuar Shpenzimet e Pranueshme në shumën e alokuar dhe nëse është e zbatueshme, deri në përqindjen e përcaktuar kundrejt çdo kategorie të tabelës së mëposhtme.

Kategoria	Shuma e Grantit të alokuar (e shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)
1. Mallra, Shërbime të Konsulencës, Kosto Operative dhe Trajnimi sipas Projektit	700,000	100%
Shuma totale	**700,000**	

3.02. Kushtet e tërheqjes. Pavarësisht nga dispozitat e seksionit 3.01 të shtojcës së kësaj Marrëveshjeje, nuk do të bëhet asnjë tërheqje për pagesat e shkaktuara/kryera përpara Datës së kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim që tërheqjet deri në një shumë agregate që nuk tejkalon shumën 140,000$ ekuivalente mund të bëhet për pagesat e bëra para kësaj date por në ose pas datës 30 nëntor 2021, për Shpenzimet e Pranueshme.

3.03. Periudha e tërheqjes. Periudha e mbylljes është data 31 korrik 2025.

Neni IV
Mjetet ligjore shtesë

4.01. **Ngjarja shtesë e pezullimit**. Ngjarja shtesë e pezullimit të përmendur në seksionin 4.02 (k) të Kushteve Standarde konsiston në sa më poshtë, konkretisht se Legjislacioni i Sekretariatit Kombëtar të EITI-t është ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar, anuluar ose hequr dorë për të ndikuar materialisht dhe negativisht, sipas opinionit të Bankës, në aftësinë e Përfituesit për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni V
Efektshmëria; ndërprerja

5.01. Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi deri atëherë kur dëshmia e pranueshme për Bankën t'i jetë dhënë Bankës se është përmbushur kushti i specifikuar më poshtë:

a) Ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Përfituesit është autorizuar dhe ratifikuar

rregullisht nga të gjitha veprimet e nevojshme qeveritare.

5.02. Si pjesë e dëshmisë që duhet të jepet në bazë të seksionit 5.01, Bankës do t'i jepet një opsion ose opinione të pranueshme për Bankën të këshilltarit të pranueshëm për Bankën, ose nëse Banka e kërkon, një certifikatë të pranueshme për Bankën të një zyrtari kompetent të vendit anëtar, që tregon çështjet e mëposhtme:

a) Në emër të Përfituesit, se kjo Marrëveshje është autorizuar ose ratifikuar rregullisht nga, dhe ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të tij dhe përbën detyrim ligjor mbi të në përputhje me kushtet e tij.

5.03. Me përjashtim siç Përfituesi dhe Banka do të bien dakord ndryshe, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur Banka i jep Përfituesit njoftimin e pranimit nga ana e saj të dëshmisë së kërkuar në bazë të seksionit 5.01 ("Data e Hyrjes në Fuqi"). Nëse, përpara Datës së Hyrjes në Fuqi, ka ndodhur ndonjë ngjarje që do t'i kishte dhënë Bankës të drejtën për të pezulluar të drejtën e Përfituesit për të bërë tërheqje nga Shuma e Grantit, nëse kjo Marrëveshje do të kishte qenë në fuqi, Banka mund të shtyjë dërgimin e njoftimit të përmendur në këtë seksion deri kur kjo ngjarje (ose ngjarjet) të pushojë së ekzistuari.

5.04. Ndërprerja për mospërmbushjen për hyrje në fuqi. Kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e Palëve sipas saj do të ndërpriten nëse nuk ka hyrë në fuqi deri në datën nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje, në rast se Banka, pas marrjes në konsideratë të arsyeve të vonesës, vendos një datë më të vonshme për qëllimin e këtij seksioni. Banka do të njoftojë menjëherë Përfituesin për një datë të tillë të mëvonshme.

Neni VI
Përfaqësuesi i Përfituesit; adresat

6.01. **Përfaqësuesi i Përfituesit**. Përfaqësuesi i Përfituesit, i përmendur në seksionin 7.02 të Kushteve Standarde, është ministri i Financave dhe Ekonomisë.

6.02. **Adresa e Përfituesit**. Për qëllimet e seksionit 7.01 të Kushteve Standarde:

a) Adresa e Përfituesit është:
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" 3
Tiranë
Shqipëri; dhe

b) Adresa elektronike e Përfituesit është:
Faks: *E-mail*: sekretariamin@financa.gov.al
+355 4 222 8405

6.03. **Adresa e Bankës**. Për qëllimet e seksionit 7.01 të Kushteve Standarde:

a) Adresa e Bankës është:
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim
1818 H Street, N.W., Washington, D.C. 20433
United States of America; dhe

b) Adresa elektronike e Bankës është:
Teleks: Faks:
248423 (MCI) ose 1-202-477-6391
64145 (MCI)

VENDIM
Nr. 757, datë 20.12.2023

PËR MIRATIMIN E REZOLUTAVE NR. 259, "NDRYSHIM NË NENIN 1 TË MARRËVESHJES, QË THEMELON BANKËN EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR MUNDËSIMIN E NJË ZGJERIMI TË KUFIZUAR DHE RRITËS TË SHTRIRJES GJEOGRAFIKE TË OPERACIONEVE TË BANKËS PËR AFRIKËN SUB-SAHARIANE DHE IRAKUN", DHE NR. 260, "NDRYSHIM NË NENIN 12.1 TË MARRËVESHJES, QË THEMELON BANKËN EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR HEQJEN E KUFIZIMIT TË KAPITALIT STATUTOR PËR OPERACIONET E ZAKONSHME", TË VITIT 2023, TË BORDIT TË GUVERNATORËVE TË BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7525, datë 3.12.1991, "Për anëtarësinë e Republikës së Shqipërisë në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim", dhe të nenit 2, të ligjit nr. 10429, datë 9.6.2011, "Për ratifikimin e vendimeve të Bordit të Guvernatorëve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), rezoluta nr. 126, "Rritja e kapitalit themeltar të autorizuar, emetimi i aksioneve të paguara dhe pagesa, nëpërmjet rialokimit të të ardhurave neto" (shtojca A) dhe rezoluta nr. 128, "Shtimi i kapitalit themeltar të autorizuar, emetimi dhe nënshkrimi i kapitalit të

shlyeshëm, nëse kërkohet dhe shlyerja" (shtojca B), si dhe dokumenti "Informacion për hapat që duhet të merren pas mbledhjes vjetore të vitit 2010", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rezolutave nr. 259, "Ndryshim në nenin 1 të marrëveshjes, që themelon Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për mundësimin e një zgjerimi të kufizuar dhe rritës të shtrirjes gjeografike të operacioneve të Bankës për Afrikën Sub-Sahariane dhe Irakun", dhe nr. 260, "Ndryshim në nenin 12.1 të marrëveshjes, që themelon Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për heqjen e kufizimit të kapitalit statutor për operacionet e zakonshme", të vitit 2023, të Bordit të Guvernatorëve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REZOLUTA NR. 259
NDRYSHIM NË NENIN 1 TË MARRËVESHJES QË THEMELON BANKËN EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR MUNDËSIMIN E NJË ZGJERIMI TË KUFIZUAR DHE RRITËS TË SHTRIRJES GJEOGRAFIKE TË OPERACIONEVE TË BANKËS PËR AFRIKËN SUB-SAHARIANE DHE IRAKUN

BORDI I GUVERNATORËVE,

Duke sjellë në vëmendje Rezolutën nr. 248, me të cilën Bordi i Guvernatorëve miratoi në parim, një zgjerim të kufizuar dhe rritës të shtrirjes gjeografike të operacioneve të Bankës në Afrikën Sub-Sahariane dhe Irak;

Duke theksuar rëndësinë e Afrikës Sub-Sahariane dhe Irakut për arritjen e prioriteteve gjeopolitike dhe të zhvillimit të komunitetit ndërkombëtar, lidhjet në rritje midis shumë vendeve në Afrikën Sub-Sahariane dhe Irakut dhe vendeve aktuale të operacioneve të BERZH-it, dhe rëndësinë dhe zbatueshmërinë e mandatit të Bankës, modelin e biznesit, fokusin në sektorin privat dhe kompetencat në Afrikën Sub-Sahariane dhe Irak;

Duke theksuar se prioriteti më urgjent i Bankës mbetet që të mbështesë Ukrainën dhe vendet e tjera të operacioneve të prekura nga lufta në Ukrainë;

Duke pranuar se lufta në Ukrainë ka përforcuar rëndësinë paralele të vazhdimit të adresimit të objektivave të grupeve të interesit në Afrikën Sub-Sahariane dhe Irak;

Duke nënvizuar se çdo zgjerim i mundshëm i kufizuar dhe rritës në vendet e reja të operacioneve nuk duhet të dëmtojë aftësinë e Bankës për të mbështetur vendet e veta aktuale të operacioneve, të komprometojë vlerësimin e kapaciteteve jashtëzakonisht të larta të Bankës për të përmbushur detyrimet financiare, të çojë në një kërkesë për kontribute kapitali shtesë ose të devijojë nga mandati i Bankës për të mbështetur tranzicionin dhe parimet e saj të funksionimit të mbështetjes së projekteve të investimeve dhe shërbimit të qëndrueshëm bankar;

Pas shqyrtimit të Raportit të Bordit të Drejtorëve për Bordin e Guvernatorëve: *"Ndryshimi i nenit 1 të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me qëllim mundësimin e zgjerimit të kufizuar dhe rritës të shtrirjes gjeografike të operacioneve të Bankës në Afrikën Sub-Saharane dhe Irak",* dhe duke qenë në pajtim me konkluzionet e saj, ndër të tjera, se:

i. Analiza e implikimeve të kapitalit dhe financiare rikonfirmon se një zgjerim i kufizuar dhe rritës në Afrikën Sub-Sahariane dhe Irak nuk do të dëmtojë në vetvete aftësinë e Bankës për të mbështetur vendet e saj ekzistuese të operacioneve, duke kompromentuar vlerësimin e kapaciteteve jashtëzakonisht të larta të Bankës për të përmbushur detyrimet financiare, ose të çojë në një kërkesë për kontribute kapitali shtesë;

ii. Një zgjerim i tillë i kufizuar dhe rritës i shtrirjes gjeografike të operacioneve të Bankës në Afrikën Sub-Sahariane dhe Irak duhet të mundësohet nëpërmjet një ndryshimi të nenit 1 të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Marrëveshja); dhe

iii. Zbatimi i zgjerimit duhet të kryhet në një mënyrë që nuk do të zbehë fokusin e Bankës në mbështetjen e Ukrainës dhe vendeve të tjera të operacioneve të prekura nga lufta në Ukrainë.

VENDOS QË:

1. Neni 1 i Marrëveshjes të ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

"Duke kontribuar në progresin dhe rindërtimin ekonomik, qëllimi i Bankës do të jetë të nxisë tranzicionin drejt ekonomive të hapura të orientuara nga tregu dhe të promovojë iniciativën private dhe sipërmarrëse në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, të përkushtuara ndaj dhe që zbatojnë parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut. Në bazë të të njëjtave kushte, qëllimi i Bankës mund të realizohet gjithashtu, në: i. Mongoli; dhe ii. në vendet anëtare të Mesdheut Jugor dhe Lindor; dhe iii. një numër i kufizuar vendesh anëtare të Afrikës Sub-Sahariane: në secilin rast nënpikat "ii" dhe "iii", siç përcaktohet nga Banka me votën pro të jo më pak se dy të tretave e guvernatorëve, që përfaqësojnë jo më pak se tre të katërtat e totalit të fuqisë votuese të anëtarëve. Si rrjedhojë, çdo referencë në këtë Marrëveshje dhe anekset e saj për "vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore"; "vendet nga Evropa Qendrore dhe Lindore", "vendi (ose vendet) përfitues" ose "vendi anëtar (ose vendet) përfitues" do t'i referohet Mongolisë dhe, gjithashtu, secilit prej vendeve të tilla të Mesdheut Jugor dhe Lindor dhe të Afrikës Sub-Sahariane.".

a) Termi "Afrikë Sub-Sahariane", siç përcaktohet në nenin 1 të Marrëveshjes do të kuptohet se nënkupton rajonin e Afrikës Sub-Sahariane që përcaktohet nga Grupi i Bankës Botërore.

b) Kufizimi i numrit të vendeve anëtare të Afrikës Sub-Sahariane në të cilat Banka mund të përmbushë qëllimin e saj, siç përcaktohet në nenin 1 të Marrëveshjes, do të kuptohet në mënyrë që të mundësojë një zgjerim të kufizuar dhe rritës të shtrirjes gjeografike të operacioneve të Bankës, në përputhje me masat dhe mekanizmat e përcaktuar në raportin e Bordit të Drejtorëve, *"Ndryshimi i Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për të mundësuar zgjerimin e kufizuar dhe rritës të shtrirjes gjeografike të operacioneve të Bankës në Afrikën Sub-Saharane dhe Irak"*. Në këtë kontekst, kërkohet një votë pro prej jo më pak se tre të katërtat e guvernatorëve që përfaqësojnë jo më pak se katër të pestat e fuqisë totale votuese të anëtarëve për të miratuar çdo rritje të mëtejshme të zgjerimit.

c) Iraku do të përfshihet në rajonin e Mesdheut Jugor dhe Lindor për qëllimet e Marrëveshjes dhe, rrjedhimisht termi "Mesdheu Jugor dhe Lindor", siç përcaktohet në nenin 1 të Marrëveshjes, do të kuptohet se nënkupton rajonin që përbëhet nga vendet që kanë një vijë bregdetare në Mesdhe, si dhe Jordani dhe Irak, të cilat janë të integruara ngushtë në këtë rajon.

2. Anëtarët e Bankës do të pyeten nëse e pranojnë ndryshimin në fjalë, duke: a) ekzekutuar dhe depozituar pranë Bankës një instrument që deklaron se ky anëtar ka pranuar ndryshimin në fjalë, në përputhje me ligjin e tij; dhe b) duke dhënë prova, në formë dhe në thelb të pranueshme për Bankën, që ndryshimi është pranuar dhe instrumenti i pranimit është ekzekutuar dhe depozituar në përputhje me ligjin e atij anëtari.

3. Ndryshimi në fjalë do të hyjë në fuqi 3 (tre) muaj pas datës në të cilën Banka u ka konfirmuar zyrtarisht anëtarëve të saj, se kërkesat për pranimin e ndryshimit në fjalë, siç parashikohet në nenin 56 të Marrëveshjes, janë përmbushur.

(Miratuar në datën 18 maj 2023)

REZOLUTA NR. 260
NDRYSHIM NË NENIN 12.1 TË MARRËVESHJES QË THEMELON BANKËN EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR HEQJEN E KUFIZIMIT TË KAPITALIT STATUTOR PËR OPERACIONET E ZAKONSHME

BORDI I GUVERNATORËVE,

Duke pranuar rolin thelbësor të Bankave të Zhvillimit Shumëpalësh (BZHSH) në trajtimin e sfidave të shumta urgjente globale;

Duke theksuar ndryshimet e konsiderueshme në praktikat e menaxhimit të kapitalit në sektorin financiar që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes më 28 mars 1991;

Me dëshirën për të mundësuar përdorimin optimal të kapacitetit të kapitalit të Bankës për të mbështetur Bankën në arritjen e ndikimit të mundshëm maksimal në vendet përfituese të saj;

Duke pranuar me kënaqësi rekomandimet me fushë të gjerë veprimi të Rishikimit të Pavarur të G20 të Kornizave të Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe shqyrtimin e kujdesshëm që iu është dhënë atyre nga Banka, përfshirë veçanërisht rekomandimin për të modernizuar qasjen e BZHSH-ve për menaxhimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, duke zhvendosur kufijtë e stimulit specifik nga statutet e BZHSH-së për kornizat e mjaftueshmërisë së kapitalit të BZHSH-së në një mënyrë të koordinuar ndërmjet BZHSH-ve;

Duke marrë parasysh dhe duke qenë në pajtim me raportin e Bordit të Drejtorëve, *"Ndryshimi i nenit 12.1 të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me qëllim heqjen e kufizimit të kapitalit statutor për operacionet e zakonshme",* dhe rekomandimin e tij për të miratuar një ndryshim të nenit 12.1 të Marrëveshjes për të hequr kufizimin e kapitalit statutor për operacionet e zakonshme; dhe

Me mirëkuptimin që Bordi i Drejtorëve do të ruajë një kufi të duhur nominal të stimulit mbi operacionet, të vendosur kundrejt matjeve përkatëse të kapitalit, brenda kuadrit të mjaftueshmërisë së kapitalit të Bankës, si pjesë e përgjegjësisë së saj për të mbrojtur qëndrueshmërinë financiare dhe qëndrueshmërinë e Bankës.

VENDOS QË:

1. Neni 12.1 i Marrëveshjes ndryshohet duke fshirë tekstin e saj ekzistues dhe duke paraqitur një tekst të ri, si më poshtë:

"Bordi i Drejtorëve do të vendosë dhe ruajë kufijtë e duhur në lidhje me matjet e mjaftueshmërisë së kapitalit, në mënyrë që të mbrojë qëndrueshmërinë financiare dhe qëndrueshmërinë e Bankës".

2. Anëtarët e Bankës do të pyeten nëse e pranojnë ndryshimin në fjalë, duke: a) ekzekutuar dhe depozituar pranë Bankës një instrument që deklaron se ky anëtar ka pranuar ndryshimin në fjalë në përputhje me ligjin e tij; dhe b) duke dhënë prova, në formë dhe thelb të pranueshme për Bankën, që ndryshimi është pranuar dhe instrumenti i pranimit është ekzekutuar dhe depozituar në përputhje me ligjin e atij anëtari

3. Ndryshimi në fjalë do të hyjë në fuqi 3 (tre) muaj pas datës në të cilën Banka u ka konfirmuar zyrtarisht anëtarëve të saj se kërkesat për pranimin e ndryshimit në fjalë, siç parashikohet në nenin 56 të Marrëveshjes, janë përmbushur.

(Miratuar në datën 18 maj 2023)

VENDIM
Nr. 762, datë 20.12.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 10, DATË 7.1.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES 'PËR LICENCIMIN DHE INSPEKTIMIN E VEPRIMTARIVE ME BURIME TË RREZATIMEVE JONIZUESE'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregulloren "Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese", të miratuar me vendimin nr. 10, datë 7.1.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese'", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Paragrafi i parë dhe i tretë i pikës 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"Licenca për veprimtari me burime rrezatimi jonizues është për një afat 10-vjeçar dhe nuk transferohet te të tretë. Licenca publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.".

"Licenca rinovohet në përfundim të afatit të vlefshmërisë së licencës.

Rinovimi i licencës për subjektet fizike ose juridike realizohet, duke plotësuar kriteret e parashikuara në pikën 3 të kësaj rregulloreje. Procedura e shqyrtimit të rinovimit të licencës kryhet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, në përputhje me parashikimet e pikës 3, të kësaj rregulloreje.

Licenca ndryshohet, kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë ndodh ndryshimi i të dhënave të përcaktuara në kriteret e licencimit.

Kërkesa për ndryshim të licencës dhe njoftimi në Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet për çdo ndryshim, që parashikohet të kryhet në veprimtari ose burime, paraqitet 60 ditë para ndryshimeve.”.

2. Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti ka të drejtë të ankohet pranë Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet brenda 30 ditëve.

Kundër vendimit të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, subjekti ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 45 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit.”.

3. Pas pikës 10 shtohen pikat 11, 12 dhe 13, me këtë përmbajtje:

“11. Licenca për veprimtari me burime rrezatimi jonizues shfuqizohet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, me propozimin e Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet, në këto raste:

a) kur subjekti i licencuar transferon veprimtarinë në një vend tjetër;

b) kur subjekti i licencuar nuk përmbush më ose shkel detyrimet për kriteret e mbrojtjes nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin në veprimtarinë që ushtron.

Kundër vendimit të Komisionit të Mbrojtjes nga rrezatimet, subjekti ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 45 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit.

12. Licencimi i veprimtarisë me burime rrezatimi jonizues shoqërohet me tarifë, e cila përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe paguhet në momentin e paraqitjes së kërkesës për licencë, për rinovim licence ose për ndryshimin e saj.

13. Afat i vlefshmërisë së licencës, i parashikuar në paragrafin e parë, të pikës 4, të këtij vendimi, vlen edhe për licencat aktive deri në momentin e plotësimit të afatit 10-vjeçar, afat që llogaritet duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të licencës.”.

4. Dy formularët bashkëlidhur rregullores “Aplikimi për licencë për veprimtari me burime të mbyllura radioaktive, kërkesë për licencë për veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese dhe aplikimi për licencë për veprimtari me gjeneratorë me rreze X, kërkesë për licencë për veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, gjeneratorë me rreze X ndryshohen në 7 formularë, si më poshtë vijon:

a) kërkesë për licencë për veprimtari me burime radioaktive, ruajtje-trajtim;

b) kërkesë për licencë për veprimtari me burime radioaktive, përdorim;

c) kërkesë për licencë për veprimtari me burime radioaktive, transport;

d) kërkesë për licencë për veprimtari me gjeneratorë me rreze X, përdorim;

e) kërkesë për licencë për veprimtari import-eksport, burime radioaktive;

f) kërkesë për licencë për veprimtari me gjeneratorë/llambë me rreze X, instalim/mirëmbajtje;

g) kërkesë për licencë për veprimtari me gjeneratorë me rreze X/llambë me rreze X, import/eksport.

II. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KËRKESË PËR LICENCË PËR VEPRIMTARI IMPORT/EKSPORT
BURIME RADIOAKTIVE

- Personi juridik/fizik: _____

Emri Mbiemri (përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Tel. _____
E-mail _____
Ekstrakti i regjistrimit në QKB_____

- Të përshkruhen kategoritë e burimeve radioaktive, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me import/eksportin.

_____
_____

Rregullat e brendshme dhe supervizimi. Të paraqitet një informacion mbi funksionimin e brendshëm të subjektit.

Dokumente për t'u ngarkuar në sistem, sipas renditjes:

1. Rregullore e brendshme mbi menaxhimin e burimeve radioaktive gjatë import/eksportit/et;
2. Një dokument i veçantë për strukturën organizative;
3. Listën e punëmarrësve;
4. Për ruajtjen e përkohshme ngarkoni licencë për ruajtje dhe trajtim burimesh radioaktive, ose kontratën me një subjekt, i cili zotëron një licencë të tillë, sipas sqarimit në pikën nr. 1;
5. Dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit, sipas sqarimit në pikën nr. 2 .

Burimet radioaktive nuk duhet të transferohen te subjekte, të cilat nuk disponojnë licencën përkatëse për përdorimin, ruajtjen etj.

Duke mbajtur përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format PDF me ngjyra.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licencë. Bazuar në nenin 3 të rregullores të miratuar me vendimin nr. 10 datë 7.1.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese'", për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik aplikon jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Procedurave Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga paraqitja e plotë e dokumentacionit.

Shënim:

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.
2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë
Burime radioaktive
Import-eksport

Pika 1. Për ruajtjen e përkohshme të burimeve radioaktive duhet të pajiseni me licencë për ruajtje dhe trajtim burimesh radioaktive, ose duhet të keni një kontratë me një subjekt, i cili zotëron një licencë të tillë, ku të sqarohen detyrimet e secilës palë për pranimin dhe kthimin e burimit sipas nevojave.

Pika 2. Paraqit me shkrim mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit për të gjitha burimet radioaktive që importohen/eksportohen, listën e të gjitha subjekteve ku do të transferohen, lejet e import/eksportit të lëshuara nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, ose Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe certifikatën e cilësisë të burimit radioaktiv.

KËRKESË PËR LICENCË PËR VEPRIMTARI ME GJENERATORË ME RREZE X

PËRDORIM

- Personi juridik/fizik: _____

Emri Mbiemri (përfaqësuesi ligjor) _____

Adresa _____

Adresa ku kryhet veprimtaria, n.q.s. është e ndryshme nga më sipër

_____

Tel._____

E-mail _____

Ekstrakti i regjistrimit në QKB_____

- Lloji i gjeneratorit me rreze X, kontrolli teknik (ct skaner, radiografi, grafi, panorameks, mamografi, densitometër, koronografi etj.):

Prodhuesi i pajisjes _____

Modeli i pajisjes_____

Numri i serisë i pajisjes_____

Tensioni maksimal_____

Rryma maksimale_____

Koha javore e ekspozimit _____

Ngarkesa javore _____

Numri i tubave_____

Modeli për çdo tub me rreze X_____

Numrat e serisë për çdo tub me rreze X_____

Shto pajisje

- Qëllimi i përdorimit të gjeneratorëve me rreze _____

- Plotëso të dhënat mbi subjektin e autorizuar i cili do të kryejë shërbimet (mirëmbajtjen, instalimin) e pajisjeve me rreze X. Nr. i licencës mbi subjektin e autorizuar _____

- Paraqit me shkrim informacion të dozave në zonat publike _____

në zonat e kontrolluara _____

në zonat e survejuara _____

- Paraqit me shkrim informacion mbi justifikimin, optimizimin e ekspozimeve të publikut, stafit dhe pacientëve dhe kufizimin e ekspozimeve publike dhe të stafit, për përdorimin e gjeneratorëve me rreze X _____

- Paraqit të dhëna mbi personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet

Emri_____

Mbiemri_____

Dokumente për t'u ngarkuar në sistem, sipas renditjes:

1. Planimetrinë me të dhënat, sipas sqarimit në pikën nr. 1;

2. Dokument zyrtar mbi destinacionin e ambientit, sipas sqarimit në pikën nr. 2;
3. Dokument në lidhje me mënyrën se si është përfituar gjeneratori me rreze X (dokumenti i blerjes/dhurimit);
4. Certifikatën e kontrollit teknik dhe testet për çdo pajisje, sipas VKM-së nr. 404, datë 18.6.2014, sipas sqarimit në pikën nr. 3;
5. Kontratën me subjektin e autorizuar i cili do të kryejë shërbimet (mirëmbajtjen, instalimin) të pajisjeve me rreze X;
6. Një dokument veçantë strukturën organizative, sipas sqarimit në pikën nr. 5;
7. Listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjen ku është inkorporuar, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara;
8. Diplomë ose certifikatë profesionale për çdo punëmarrës;
9. Certifikatë trajnimi për çdo punëmarrës;
10. Vërtetim testimi për çdo punëmarrës;
11. Kontratën me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me gjeneratorë me rreze X, sipas listës së deklaruar të punëmarrësve, sipas sqarimit në pikën nr. 5;
12. Kontratën e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta, sipas sqarimit në pikën nr. 6;
13. Planin e reagimit në rast incidenti;
14. Rregullore e brendshme për përdorimin e gjeneratorëve me rreze X, kode praktike etj.;
15. Dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit, sipas sqarimit në pikën nr. 7;
16. Raportin e vlerësimit të sigurisë dhe të mbrojtjes nga rrezatimet, sipas sqarimit në pikën 8;
17. Raportin mjekësor i aftësisë për punë me burime radioaktive lëshuar nga ISHP-ja për çdo punëmarrës.

Duke mbajtur përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format PDF me ngjyra.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licencë. Bazuar në nenin 3 të rregullores të miratuar me vendimin nr. 10, datë 7.1.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese'", për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik aplikon jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Procedurave Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga paraqitja e plotë e dokumentacionit.

Shënim:

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.

2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues, në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë
Përdorim
Gjeneratorë me rreze X

Pika 1. Paraqit planimetrinë e ambienteve, vendndodhjes së panelit të kontrollit, pajisjeve mbrojtëse të lëvizshme, dyerve, dritareve, ventilatorëve, pasazheve, dhomës së errët, ambienteve të pritjes së

pacientëve, qëndrimin e personelit, ambientet rreth kabinetit, materialin dhe dimensionet përkatëse. Paraqit me ngjyra zonat e kontrolluara, të survejuara dhe zonat publike.

Planimetria të paraqitet në një format të qartë dhe të specifikuar në mënyre të dukshme me të gjitha elementet.

Pika 2. Të paraqitet një dokument zyrtar, i cili përcakton destinacionin e ambienteve ku do ushtrohet veprimtaria. (Sipas urdhrit nr. 415, datë 11.10.2011, të ministrit të Shëndetësisë për ndërtimin e kabineteve të radiologjisë dhe ato me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive).

Pika 3. Për realizimin e kontrollit teknik referoju faqes zyrtare: http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/ku përcaktohet lista e personave/subjekteve të njohur nga KMR-ja për këtë qëllim.

Pika 4. Paraqit në një dokument veçantë strukturën organizative dhe listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me gjeneratorin/ët me rreze X, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara. Paraqit dokumentacionin, në lidhje me kualifikimet dhe eksperiencat e stafit. Të ngarkohen diplomë/certifikatë që vërteton kompetencën profesionale të tij/saj në lidhje me punën që do të kryejë, si dhe certifikatë trajnimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese lëshuar nga institucionet e njohura nga KMR-ja, të ngarkohet vërtetimi i testimit. Ritrajnimi dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet kryhet çdo pesë vjet. Për realizimin e trajnimit dhe testimit të njohurive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, referoju faqes zyrtare: http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/ku përcaktohen institucionet e njohura për këtë qëllim.

Pika 5. Paraqit kontratën me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Tiranë, për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me gjeneratorë me rreze X, sipas listës së deklaruar të punëmarrësve e cila të jetë e përshtatshme për llojin dhe energjitë e rrezatimit që keni në përdorim. Për praktikat siç përcaktohen në nenin 31 të VKM-së nr. 801, datë 11.12.2019, për të cilat nuk është e nevojshme nënshkrimi i kontratës për dozimetrinë personale me IFBZ-në, të kryhet monitorimi i vendit të punës nga përgjegjësi i mbrojtjes nga rrezatimet ose nga një ekspert i mbrojtjes nga rrezatimet.

Pika 6. Të ngarkohen diplomë/certifikatë që vërteton kompetencën profesionale të tij/saj, në lidhje me punën që do të kryejë, si dhe certifikatë trajnimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese lëshuar nga institucionet e njohura nga KMR-ja, të ngarkohet vërtetimi i testimit. Ritrajnimi dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet kryhet çdo pesë vjet. Për realizimin e trajnimit dhe testimit të njohurive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, referoju faqes zyrtare: http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/ku përcaktohen institucionet e njohura për këtë qëllim.

Pika 7. Paraqit një dokument me shkrim për mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit për dozimetrinë personale, monitorimit të vendit të punës, incidenteve, trajnimit, shërbimeve të pajisjeve dhe kontrolli mjekësor periodik i punëmarrësve.

Pika 8. Të bëhet vlerësimi për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi, sipas udhëzuesit miratuar nga KMR-ja nr. 72/21, datë 17.8.2021. Për realizimin e raport-ekspertizës referoju faqes zyrtare: http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/ku përcaktohet lista e personave/institucioneve të njohur nga KMR-ja për realizimin e raportit/ekspertizën mbi sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese. Subjektet private për kryerjen e ekspertizës t'i referohen listës së ekspertëve të njohur nga KMR-ja, ndërsa subjektet shtetërore të kontaktojnë Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, siç përcaktohet në faqen zyrtare.

Pika 9. Të kontaktohet Instituti i Shëndetit Publik, Departamenti i Shëndetit dhe Mjedisit për plotësimin e raportit mjekësor për aftësinë në punë.

KËRKESË PËR LICENCË PËR VEPRIMTARI ME GJENERATORË ME RREZE X/LLAMBË ME RREZE X

IMPORT/EKSPORT

- Personi juridik/fizik: _____
Emri Mbiemri (përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Tel._____
E-mail _____
Ekstrakti i regjistrimit në QKB_____

Dokumente për t'u ngarkuar në sistem, sipas renditjes:

1. Dokumenti me llojet e pajisjeve që do të importohen/eksportohen, sipas funksionit (ct skaner, radiografi, grafi, panorameks, mamografi, densitometër, koronografi etj.), si dhe të sqarohet nëse do të importohen/eksportohen llamba me rreze X;
2. Rregullore e brendshme mbi menaxhimin e import/eksportit të gjeneratorëve dhe llambave me rreze X, sipas sqarimit në pikën nr. 1;
3. Dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit, sipas sqarimit në pikën nr. 2.

Duke mbajtur përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format PDF me ngjyra.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licencë. Bazuar në nenin 3 të rregullores të miratuar me vendimin nr. 10, datë 7.1.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese'", për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik aplikon jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Procedurave Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga paraqitja e plotë e dokumentacionit.

Shënim:

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.
2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë
Gjeneratorë/llambë me rreze X
Import/eksport

Pika 1. Të paraqitet një rregullore e brendshme e subjektit. Në rregullore të përcaktohet qartë që subjekti nuk transferon pajisje me rreze X ose llambë me rreze X në subjekte të cilat nuk disponojnë licencën përkatëse. Të përcaktohet qartë adresa e magazinimit të pajisjeve dhe e llambave me rreze X të importuara.

Pika 2. Paraqit me shkrim mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit për të gjitha pajisjet dhe llambat me rreze X, që importohen/eksportohen, listën e të gjitha subjekteve ku do të transferohen, lejet e import/eksportit të lëshuara nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, certifikatën e cilësisë së gjeneratorit me rreze X.

KËRKESË PËR LICENCË PËR VEPRIMTARI ME BURIME RADIOAKTIVE

RUAJTJE-TRAJTIM

- Personi juridik/fizik: _____
Emri Mbiemri (përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Adresa ku kryhet veprimtaria, n.q.s. është e ndryshme nga më
_____
Tel._____
E-mail _____
Ekstrakti i regjistrimit në QKB_____
- Paraqit me shkrim informacion të dozave në zonat publike _____
në zonat e kontrolluara _____
në zonat e survejuara _____
- Paraqit të dhëna mbi personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet
Emri_____
Mbiemri_____
- Paraqit të dhëna mbi personin përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet veprimtaria ku përdoren burime radioaktive
Emri_____
Mbiemri_____

Dokumente për t'u ngarkuar në sistem sipas renditjes:
1. Planimetrinë me të dhënat, sipas sqarimit në pikën nr. 1;
2. Dokument zyrtar mbi destinacionin e ambientit, sipas sqarimit në pikën nr. 2;
3. Plani i sigurimit për burimet radioaktive, sipas sqarimit në pikën nr. 3;
4. Raportin e vlerësimit të sigurisë dhe prezantimi i *safety case,* sipas sqarimit në pikën 4;
5. Paraqit me tabelë inventarin me karakteristikat dhe të dhënat e burimeve radioaktive në ruajtje, kondicionim etj.;
6. Programin e monitorimit të mjedisit;
7. Rregullore e brendshme për ruajtje dhe trajtimin e burimeve radioaktive;
8. Një dokument veçantë strukturën organizative, sipas sqarimit në pikën nr. 5;
9. Listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjen ku është inkorporuar, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara;
10. Diplomë ose certifikatë profesionale për çdo punëmarrës;
11. Certifikatë trajnimi për çdo punëmarrës;
12. Vërtetim testimi për çdo punëmarrës;
13. Kontratën me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me burimet radioaktive, sipas listës së deklaruar të punëmarrësve, sipas sqarimit në pikën nr. 6;
14. Kontratën e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta, sipas sqarimit në pikën nr. 7;
15. Kontratën e punës për personin përgjegjës për sigurimin fizik, me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta, sipas sqarimit në pikën nr. 7;
16. Planin e përgatitjes dhe reagimit në rast incidenti, aksidenti ose eventi radiologjik;
17. Formatin dhe regjistrin kombëtar të mbetjeve radioaktive;
18. Formatin e regjistrit të shkarkimeve në mjedis;
19. Formatin mbi njoftimin e humbjes, vjedhjes ose sabotimit;

20. Raportin mjekësor i aftësisë për punë me burime radioaktive lëshuar nga ISHP për çdo punëmarrës.

Burimet radioaktive nuk transferohen në subjekte të cilat nuk disponojnë licencën përkatëse.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format PDF me ngjyra.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licencë. Bazuar në nenin 3 të rregullores të miratuar me vendimin nr. 10, datë 7.1.2010, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores 'Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese"', për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik aplikon jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Procedurave Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga paraqitja e plotë e dokumentacionit.

Shënim:

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.

2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë
Burime radioaktive
Ruajtje-trajtim

Pika 1. Planimetria të paraqitet në një format të përshtatshëm dhe të specifikojë në mënyre të dukshme të gjitha elementet, ambientet, vendndodhjen e burimit/eve radioaktiv/e, pajisjeve mbrojtëse të lëvizshme, dyerve, dritareve, ventilatorëve, pasazheve, qëndrimin e personelit, ambientet rreth kabinetit, materialin dhe dimensionet përkatëse. Paraqit me ngjyra zonat e kontrolluara, të survejuara dhe zonat publike.

Pika 2. Të dokumentohet destinacioni i ambienteve. Të paraqitet një dokument zyrtar, i cili përcakton destinacionin e ambienteve ku do ushtrohet veprimtaria. (Sipas urdhrit nr. 415, datë 11.10.2011, të ministrit të Shëndetësisë për ndërtimin e kabineteve të radiologjisë dhe ato me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive.)

Pika 3. Të paraqitet plani i sigurimit për burimet radioaktive të kategorisë I, II dhe III, sipas udhëzuesit të KMR-së nr. 444/8, datë 29.3.2019. Të paraqitet plani i sigurimit fizik për përdorimin e burimeve radioaktive të kategorisë I, II dhe III, i cili të jetë në përputhje me rregulloren nr. 877 datë 30.10.2015, "Mbi sigurimin fizik të materialeve radioaktive", si dhe udhëzuesin nr. 444/8, datë 29.3.2019.

Për përgatitjen e këtij plani të kontaktohet personi i ngarkuar nga Policia e Shtetit në Drejtoritë vendore të policisë/komisariati i policisë, aty ku subjekti ushtron veprimtarinë për ruajtje/trajtim të burimeve radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3.

Referoju faqes zyrtare të internetit http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/.

Pika 4. Raporti i vlerësimit të sigurisë dhe prezantimi i *safety case*, të përmbajë vlerësimin për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi në analogji me udhëzimin e miratuar nga KMR-ja nr. 72/21 datë 17.8.2021. Plani të përmbajë elementet e mëposhtme, në përputhje me rregulloren nr. 638, datë 7.9.2016, për trajtimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë.

a) Qëllimi i ruajtjes dhe i trajtimit të burimit/eve radioaktiv/e;

b) programet operative të menaxhimit të mbetjeve radioaktive;

c) financimin për trajtimin e mbetjeve;

d) kushtet e përgjithshme për kontrollin e prodhimit të mbetjeve;
e) minimizimin e prodhimit të mbetjeve;
f) ripërdorimin dhe riciklimin e burimeve që nuk përdoren më;
g) heqjen nga kontrolli rregullator;
h) kriteret e pranimit;
i) sqarime mbi moshollimin e mbetjeve me qëllim shkarkimet në mjedis;
j) shkarkimi i mbetjeve radioaktive në mjedis;
k) karakteristikat e mbetjeve radioaktive;
l) klasifikimin e mbetjeve;
m) ndarjen e mbetjeve radioaktive;
n) trajtimi dhe kondicionimi;
o) paketimi;
p) kushtet e përgjithshme për ruajtjen e përkohshme;
q) elemente të depos për ruajtje të përkohshme;
r) ruajtja afatgjatë;
s) kushtet speciale në rast mospërputhje me kriteret e pranimit;
t) programi i monitorimit;
u) rishikime periodike të sigurisë, paraqit me shkrim një informacion, në lidhje me:
v) shkarkimet në mjedis
w) elemente të përgjithshme për çmontimin e depos;
x) kushtet speciale në rast mospërputhje me kriteret e pranimit;
y) programi i monitorimit;
z) rishikime periodike të sigurisë;
aa) elemente të përgjithshme për çmontimin e depos.

Paraqit me shkrim një dokument me informacion mbi shërbimet bazë, pajisjet që do të përdoren për ruajtjen dhe trajtimin e burimeve radioaktive. Sqaro në detaje proceset që do të kryhen dhe pajisjet që do të përdoren.

Paraqit me shkrim informacion mbi justifikimin dhe kufizimin e ekspozimeve publike dhe të stafit në procesin e ruajtjes dhe trajtimit të burimeve radioaktive

Pika 5. Subjektet që do të ruajnë /trajtojnë burime radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3 duhet të dërgojnë paraprakisht në ZMR, para fillimit të plotësimit të procedurave për licencë/amenim/rinovim, listën e punonjësve që do të kenë akses/informacion mbi burimet radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3, me qëllim dërgimin në strukturat përkatëse për verifikimin e besueshmërisë dhe përshtatshmërinë e tyre. Informacioni duhet të përfshijë për secilin të dhënat e mëposhtme;

1. Emër/mbiemër; 2. Funksioni 3; Nr. i kartës së identitetit/ose i pasaportës; 4. Nr. personal; 5. Vendlindja; 6. Vendbanimi; 7. Ditëlindja; 8. Shtetësia.

Pas marrjes së konfirmimit subjekti do të njoftohet për të vazhduar ose jo procedurat për licencë për këtë veprimtari.

Paraqit në një dokument të veçantë strukturën organizative dhe listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjen ku është inkorporuar, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara. Paraqit dokumentacionin në lidhje me kualifikimet dhe eksperiencat e stafit. Të ngarkohen diplomë/certifikatë që vërteton kompetencën profesionale të tij/saj në lidhje me punën që do të kryejë, si dhe certifikatë trajnimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese lëshuar nga institucionet e njohura nga KMR-ja, të ngarkohet vërtetimi i testimit. Ritrajnimi dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet kryhet çdo pesë vjet. Për realizimin e trajnimit dhe testimit të njohurive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, referoju faqes zyrtare: http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/ku përcaktohen institucionet e njohura për këtë qëllim.

Pika 6. Të paraqitet një kopje e kontratës për dozimetrinë personale, e cila të jetë e përshtatshme për llojin dhe energjitë e rrezatimit që keni në përdorim. Kontrata të paraqesë qartë detyrimet e secilës palë. Të kontaktohet Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar për nënshkrimin e kësaj kontrate.

Pika 7. Të plotësohen të dhënat mbi personin përgjegjës për sigurinë ndaj rrezatimit. Në qoftë se personi përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet nuk gjendet në listën e punëmarrësve të bashkëngjitet diploma/dëshmi që të vërtetojë aftësitë profesionale të tij/saj, certifikatë trajnimi dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese brenda pesë viteve të fundit, lëshuar nga institucione të njohura nga KMR-ja. Të paraqitet kontrata e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet.

Të plotësohen të dhënat mbi personin përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet veprimtaria. Në qofte se personi përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet veprimtaria nuk gjendet në listën e punëmarrësve të bashkëngjitet diploma/dëshmi që të vërtetojë aftësitë profesionale të tij/saj. Të paraqitet kontrata e punës për personin përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet veprimtaria.

KËRKESË PËR LICENCË PËR VEPRIMTARI ME BURIME RADIOAKTIVE

TRANSPORT

- Personi juridik/fizik: _____

Emri Mbiemri (përfaqësuesi ligjor) _____

Adresa_____

Tel._____

E-mail _____

Ekstrakti i regjistrimit në QKB_____

- Paraqit të dhëna të cilat ndikojnë në sigurinë gjatë transportit të burimeve radioaktive. Paraqit një informacion në lidhje me kategoritë e burimeve që do të transportohen _____

- Paraqit me shkrim një informacion se si do kryhet shërbimi i ngarkimit dhe i shkarkimit të burimeve ose materialeve radioaktive _____

- Paraqit të dhëna mbi personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet

Emri_____

Mbiemri_____

- Paraqit të dhëna mbi personin përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet veprimtaria ku përdoren burime radioaktive

Emri_____

Mbiemri_____

Dokumente për t'u ngarkuar në sistem, sipas renditjes:

1. Foto të automjetit përfshi dhe foto të zonës së ngarkesës, ku të jetë e dukshme targa e automjetit;
2. Leja e drejtimit ADR e drejtuesit të automjetit;
3. Kontrata e punës e drejtuesit të automjetit;
4. Leje/et e qarkullimit;
5. Rregullore e brendshme për transportin e burimeve radioaktive;
6. Një dokument veçantë për strukturën organizative, sipas sqarimit në pikën nr. 1;
7. Listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjen ku është inkorporuar, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara;
8. Diplomë ose certifikatë profesionale për çdo punëmarrës;
9. Certifikatë trajnimi për çdo punëmarrës;
10. Vërtetim testimi për çdo punëmarrës;
11. Kontratën me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me burimet radioaktive, sipas listës së deklaruar të punëmarrësve, sipas sqarimit në pikën nr. 2;
12. Kontratën e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta, sipas sqarimit në pikën nr. 1;

13. Kontratën e punës për personin përgjegjës për sigurimin fizik, me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta, sipas sqarimit në pikën nr. 1;
14. Planin e përgatitjes dhe reagimit në rast incidenti, aksidenti ose eventi radiologjik;
15. Dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit, sipas sqarimit në pikën nr. 3;
16. Raportin mjekësor i aftësisë për punë me burime radioaktive lëshuar nga ISHP-ja për çdo punëmarrës

Të gjitha burimet radioaktive duhet të transportohen tek= përdorues që disponojnë licencën përkatëse për posedimin e burimeve radioaktive.

Duke mbajtur përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format PDF me ngjyra.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licencë. Bazuar në nenin 3 të rregullores të miratuar me vendimin nr. 10, datë 7.1.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese"', për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik aplikon jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Procedurave Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga paraqitja e plotë e dokumentacionit.

Shënim:

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.
2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë
Burime radioaktive
Transport

Pika 1. Subjektet që do të kryejnë transport të burimeve radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3 duhet të dërgojnë paraprakisht në ZMR, para fillimit të plotësimit të procedurave për licencë/amendim/rinovim, listën e punonjësve që do të kryejnë transportin apo kanë informacion mbi burimet radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3 që do të transportohen, me qëllim dërgimin në strukturat përkatëse për verifikimin e besueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre. Informacioni duhet të përfshijë për secilin të dhënat e mëposhtme;

1. Emër/mbiemër; 2. Funksioni; 3. Nr. i kartës së identitetit/ose i pasaportës; 4. Nr. personal 5. Vendlindja; 6. Vendbanimi; 7. Ditëlindja; 8. Shtetësia.

Pas marrjes së konfirmimit subjekti do të njoftohet për të vazhduar ose jo procedurat për licencë për këtë veprimtari.

Të ngarkohen diplomë/certifikatë që vërteton kompetencën profesionale të tij/saj në lidhje me punën që do të kryejë, si dhe certifikatë trajnimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese lëshuar nga institucionet e njohura nga KMR-ja, të ngarkohet vërtetimi i testimit. Ritrajnimi dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet kryhet çdo pesë vjet. Për realizimin e trajnimit dhe testimit të njohurive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, referoju faqes zyrtare: http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/ku përcaktohen institucionet e njohura për këtë qëllim.

Pika 2. Të paraqitet një kopje e kontratës për dozimetrinë personale, e cila të jetë e përshtatshme për llojin dhe energjitë e rrezatimit që keni në përdorim. Kontrata të paraqesë qartë detyrimet e secilës palë. Të kontaktohet Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar për nënshkrimin e kësaj kontrate. Kontrata të ngarkohet në sistem.

Pika 3. Paraqit me shkrim mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit për të gjithë transportin e burimeve radioaktive dhe pajisjet ku janë të inkorporuara, sipas lejes së importit, certifikatën e cilësisë së burimit radioaktiv, kategorinë e burimit radioaktiv, informacion mbi kontejnerët dhe tipat e paketimit, dozimetrinë personale, incidenteve, trajnimit dhe kontrolli mjekësor periodik i punëmarrësve etj.

KËRKESË PËR LICENCË PËR VEPRIMTARI ME BURIME RADIOAKTIVE

PËRDORIM

- Personi juridik/fizik: _____

Emri Mbiemri (përfaqësuesi ligjor) _____

Adresa _____

Adresa ku kryhet veprimtaria, n.q.s. është e ndryshme nga më sipër

_____

Tel._____

E-mail _____

Ekstrakti i regjistrimit në QKB_____

- Të dhëna mbi burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjeve ku janë inkorporuar.

Burim/e radioaktiv/e:

Prodhuesi _____

Nr. i modelit _____

Nr. i serisë_____

Adresa e prodhuesit _____

Radionuklidi_____

Aktiviteti fillestar _____

Energjitë _____

Forma kimike dhe fizike_____

Shto burime radioaktive

Pajisja ku është inkorporuar burimi radioaktiv:

Prodhuesi i pajisjes _____

Modeli i pajisjes_____

Numri i serisë i pajisjes_____

Shto pajisje

- Qëllimi i përdorimit të burimit radioaktiv _____
_____

- Përshkruaj se kush do të kryejë shërbime të autorizuara të pajisjeve ku është i inkorporuar burimi radioaktiv ose për vetë burimin _____

- Paraqit me shkrim informacion të dozave në zonat publike _____

në zonat e kontrolluara _____

në zonat e survejuara _____

- Paraqit me shkrim informacion mbi justifikimin, optimizimin e ekspozimeve të publikut, stafit dhe pacientëve dhe kufizimin e ekspozimeve publike dhe të stafit, për përdorimin e burimeve radioaktive _____

- Paraqit të dhëna mbi personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet

Emri_____

Mbiemri_____

- Paraqit të dhëna mbi personin përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet veprimtaria ku përdoren burime radioaktive

Emri_____

Mbiemri_____

- Të paraqiten dokumente në lidhje me çmontimin, trajtimin e sigurt të burimit/eve radioaktiv/e të konsumuara, duke garantuar trajtimin në qendrat përkatëse të mbetjeve radioaktive në fund të përdorimit. Subjekti duhet të paraqesë me shkrim argumente për garanci financiare për trajtimin e burimit të konsumuar_____

Dokumente për t'u ngarkuar në sistem, sipas renditjes:

1. Planimetrinë me të dhënat, sipas sqarimit në pikën nr. 1;
2. Dokument zyrtar mbi destinacionin e ambientit, sipas sqarimit në pikën nr. 2;
3. Plani i sigurimit për burimet radioaktive, sipas sqarimit në pikën nr. 3;
4. Dokument në lidhje me mënyrën se si është përfituar burimi radioaktiv (dokumenti i blerjes/dhurimit);
5. Certifikatën/at e cilësisë së burimit/eve lëshuar nga prodhuesi;
6. Raportin e vlerësimit të sigurisë dhe të mbrojtjes nga rrezatimet, sipas sqarimit në pikën 4;
7. Rregullore e brendshme për përdorimin e burimeve radioaktive;
8. Një dokument veçantë strukturën organizative, sipas sqarimit në pikën nr. 5;
9. Listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjen ku është inkorporuar, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara;
10. Diplomë ose certifikatë profesionale për çdo punëmarrës;
11. Certifikatë trajnimi për çdo punëmarrës;
12. Vërtetim testimi për çdo punëmarrës;
13. Kontratën me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me burimet radioaktive, sipas listës së deklaruar të punëmarrësve, sipas sqarimit në pikën nr. 6;
14. Kontratën e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta, sipas sqarimit në pikën nr. 7;
15. Kontratën e punës për personin përgjegjës për sigurimin fizik, me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta, sipas sqarimit në pikën nr. 7;
16. Planin e përgatitjes dhe reagimit në rast incidenti, aksidenti ose eventi radiologjik;
17. Kontratën për kthimin në vendin e origjinës, ose kontratën për trajtimin në një qendër të licencuar për trajtimin e mbetjeve radioaktive;
18. Dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit, sipas sqarimit në pikën nr. 8;
19. Paraqit me tabelë inventarin me karakteristikat dhe të dhënat e burimeve radioaktive në përdorim;
20. Formatin e regjistrit të shkarkimeve në mjedis;
21. Formatin mbi njoftimin e humbjes, vjedhjes ose sabotimit;
22. Raportin mjekësor i aftësisë për punë me burime radioaktive lëshuar nga ISHP-ja për çdo punëmarrës.

Duke mbajtur përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format PDF me ngjyra.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licencë. Bazuar në nenin 3 të rregullores të miratuar me vendimin nr. 10, datë 7.1.2010, të Këshillit të

Ministrave "Për miratimin e rregullores 'Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese"', për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik aplikon jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Procedurave Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga paraqitja e plotë e dokumentacionit.

Shënim:

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.

2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë
Përdorim
Burime radioaktive

Pika 1. Planimetria të paraqitet në një format të përshtatshëm dhe të specifikojë në mënyrë të dukshme të gjitha elementet, ambientet, vendndodhjen e burimit radioaktiv, pajisjeve mbrojtëse të lëvizshme, dyerve, dritareve, ventilatorëve, pasazheve, ambienteve të pritjes së pacientëve, qëndrimin e personelit, ambientet rreth kabinetit, materialin dhe dimensionet përkatëse. Paraqit me ngjyra zonat e kontrolluara, të survejuara dhe zonat publike.

Pika 2. Të dokumentohet destinacioni i ambienteve. Të paraqitet një dokument zyrtar, i cili përcakton destinacionin e ambienteve ku do ushtrohet veprimtaria. (Sipas urdhrit nr. 415, datë 11.10.2011, të ministrit të Shëndetësisë për ndërtimin e kabineteve të radiologjisë dhe ato me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive).

Pika 3. Të paraqitet plani i sigurimit për burimet radioaktive të kategorisë I, II dhe III, sipas udhëzuesit të KMR-së nr. 444/8, datë 29.3.2019. Të paraqitet plani i sigurimit fizik për përdorimin e burimeve radioaktive të kategorisë I, II dhe III, i cili të jetë në përputhje me rregulloren nr. 877, datë 30.10.2015, "Mbi sigurimin fizik të materialeve radioaktive", si dhe udhëzuesin nr. 444/8, datë 29.3.2019.

Për përgatitjen e këtij plani të kontaktohet personi i ngarkuar nga Policia e Shtetit në Drejtoritë vendore të policisë/komisariati i policisë, aty ku subjekti ushtron veprimtarinë për ruajtje/trajtim të burimeve radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3.

Referoju faqes zyrtare të internetit http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/.

Pika 4. Të paraqitet vlerësimi për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi nga Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar. Paraqit me shkrim një informacion në rast se ka shkarkime në mjedis.

Për realizimin e raport-ekspertizës referoju faqes zyrtare: http://www.ishp.gov.al/të-pëgjithshme/.

Vlerësimi për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi të bëhet në analogji me udhëzimin e miratuar nga KMR-ja nr. 72/21, datë 17.8.2021.

Pika 5. Subjektet që do të përdorin burimeve radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3 duhet të dërgojnë paraprakisht në ZMR, para fillimit të plotësimit të procedurave për licencë/amendim/rinovim, listën e punonjësve që do të kenë akses dhe informacion mbi burimet radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3, me qëllim dërgimin në strukturat përkatëse për verifikimin e besueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre. Informacioni duhet të përfshijë për secilin të dhënat e mëposhtme;

1. Emër/mbiemër; 2. Funksioni; 3. Nr. i kartës së identitetit/ose i pasaportës; 4. Nr. personal 5. Vendlindja; 6. Vendbanimi; 7. Ditëlindja; 8. Shtetësia.

Pas marrjes së konfirmimit subjekti do të njoftohet për të vazhduar ose jo procedurat për licencë për këtë veprimtari.

Paraqit në një dokument veçantë strukturën organizative dhe listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjen ku është inkorporuar, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara. Paraqit dokumentacionin në lidhje me kualifikimet dhe eksperiencat e stafit. Të ngarkohen diplomë/certifikatë që vërteton kompetencën profesionale të tij/saj, në lidhje me punën që do të kryejë, si dhe certifikatë trajnimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese lëshuar nga institucionet e njohura nga KMR-ja, të ngarkohet vërtetimi i testimit. Ritrajnimi dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet kryhet çdo pesë vjet. Për realizimin e trajnimit dhe të testimit të njohurive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, referoju faqes zyrtare: http://www.ishp.gov.al/te-pergjithshme/ku përcaktohen institucionet e njohura për këtë qëllim.

Pika 6. Paraqit kontratën me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Tiranë, për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me burimet radioaktive, sipas listës së deklaruar të punëmarrësve, e cila të jetë e përshtatshme për llojin dhe energjitë e rrezatimit që keni në përdorim. Për praktikat, siç përcaktohen në nenin 31 të VKM-së nr. 801, datë 11.12.2019, për të cilat nuk është e nevojshme nënshkrimi i kontratës për dozimetrinë personale me IFBZ, të kryhet monitorimi i vendit të punës nga përgjegjësi i mbrojtjes nga rrezatimet ose nga një ekspert i mbrojtjes nga rrezatimet.

Pika 7. Të ngarkohen diplomë/certifikatë që vërteton kompetencën profesionale të tij/saj, në lidhje me punën që do të kryejë, si dhe certifikatë trajnimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese lëshuar nga institucionet e njohura nga KMR-ja, të ngarkohet vërtetimi i testimit. Ritrajnimi dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet kryhet çdo pesë vjet. Për realizimin e trajnimit dhe testimit të njohurive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, referoju faqes zyrtare: http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/ku përcaktohen institucionet e njohura për këtë qëllim.

Pika 8. Të paraqitet një dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit për të gjitha burimet radioaktive dhe pajisjet ku janë të inkorporuara, sipas lejes së importit, informacion mbi lejen/lejet e import/eksportit të lëshuara nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ose Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, certifikatën e cilësisë së burimit radioaktiv, kategorinë e burimit radioaktiv, informacion mbi kontejnerët dhe tipat e paketimit, dozimetrinë personale, izodozave, incidenteve, trajnimit, shërbimeve të pajisjeve dhe kontrolli mjekësor periodik i punëmarrësve etj.

KËRKESË PËR LICENCË PËR VEPRIMTARI ME GJENERATORË /LLAMBË ME RREZE X INSTALIM/MIRËMBAJTJE

- Personi juridik/fizik: _____

Emri Mbiemri (përfaqësuesi ligjor) _____

Adresa _____

Tel._____

E-mail _____

Ekstrakti i regjistrimit në QKB_____

- Paraqit të dhëna mbi personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet

Emri_____

Mbiemri_____

Duke mbajtur përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme.

Dokumente për t'u ngarkuar në sistem, sipas renditjes:

1. Një dokument veçantë strukturën organizative, sipas sqarimit në pikën nr. 1;
2. Listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me gjeneratorë/llambë me rreze X, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara;
3. Diplomë ose certifikatë profesionale për çdo punëmarrës;
4. Certifikatë trajnimi për çdo punëmarrës;
5. Vërtetim testimi për çdo punëmarrës;

6. Kontratën me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me gjeneratorë me rreze X, sipas listës së deklaruar të punëmarrësve, sipas sqarimit në pikën nr. 2.

7. Kontratën e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta, sipas sqarimit në pikën nr. 3;

8. Planin e reagimit në rast incidenti;

9. Rregullore e brendshme për instalimin dhe mirëmbajtjen e gjeneratorëve/llambave me rreze X;

10. Dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit, sipas sqarimit në pikën nr. 4;

11. Raportin e vlerësimit të sigurisë dhe të mbrojtjes nga rrezatimet, sipas sqarimit në pikën nr. 5;

12. Deklaratë për mosinstalimin e gjeneratorëve me rreze X në kundërshtim me urdhrin nr. 415, datë 11.10.2011, mbi destinacionin e ambientit ku ushtrohet veprimtaria;

13. Raportin mjekësor i aftësisë për punë me burime radioaktive lëshuar nga ISHP-ja për çdo punëmarrës.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format PDF me ngjyra.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licencë. Bazuar në nenin 3 të rregullores të miratuar me vendimin nr. 10, datë 7.1.2010, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores 'Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese'", për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik aplikon jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Procedurave Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga paraqitja e plotë e dokumentacionit.

Shënim:

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.

2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licence
Gjeneratorë/llambë me rreze X
Instalim/mirëmbajtje

Pika 1. Të ngarkohen diplomë/certifikatë që vërteton kompetencën profesionale të tij/saj, në lidhje me punën që do të kryejë, si dhe certifikatë trajnimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese lëshuar nga institucionet e njohura nga KMR-ja, të ngarkohet vërtetimi i testimit. Për realizimin e trajnimit dhe testimit të njohurive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, referoju faqes zyrtare: http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/ku përcaktohen institucionet e njohura për këtë qëllim.

Pika 2. Të paraqitet një kopje e kontratës për dozimetrinë personale, e cila të jetë e përshtatshme për llojin dhe energjitë e rrezatimit me të cilat do të manipuloni. Kontrata të paraqesë qartë detyrimet e secilës palë. Të kontaktohet Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar për nënshkrimin e kësaj kontrate.

Pika 3. Të plotësohen të dhënat mbi personin përgjegjës për sigurinë ndaj rrezatimit. Në qoftë se personi përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet nuk gjendet në listën e punëmarrësve, të bashkëngjitet diploma/dëshmi që të vërtetojë aftësitë profesionale të tij/saj, certifikatë trajnimi dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese brenda pesë viteve të fundit, lëshuar nga institucione të njohura nga KMR-ja. Të paraqitet kontrata e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet.

Pika 4. Të përshkruhet me shkrim mënyra e ruajtjes së të dhënave për dozimetrinë personale, incidenteve, trajnimit, testimi i stafit, shërbimeve të pajisjeve dhe kontrolli mjekësor periodik i

punonjësve. Të krijojë një bazë të dhënash për çdo pajisje që instalohet/mirëmbahet. Paraqit formatin e kësaj baze të dhënash, ku të jetë i përfshirë dhe numri i lejes së importit të pajisjes.

Pika 5. Të paraqitet vlerësimi për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi, i cili merr në konsideratë gjatë instalimit/mirëmbajtjes, si më poshtë:

Ngarkesa vjetore maksimale;

Faktori i përdorimit;

Pajisjet mbrojtëse të lëvizshme dhe ato personale;

Rrethanat e posaçme;

Vendosja e shenjave të rrezikut të rrezatimit jonizues;

Instrumentet matëse dhe kalibrimi i tyre;

Teste për rrjedhje etj.

Për realizimin e raport-ekspertizës referoju faqes zyrtare: http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/ku përcaktohet lista e personave/institucioneve të njohur nga KMR-ja, për realizimin e raportit/ekspertizën mbi sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese.

Subjektet private për kryerjen e ekspertizës t'i referohen listës së ekspertëve të njohur nga KMR-ja, ndërsa subjektet shtetërore të kontaktojnë Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, siç përcaktohet në faqen zyrtare.

VENDIM
Nr. 763, datë 20.12.2023

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KUVAJTIT, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E BUJQËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Kuvajtit, për bashkëpunimin në fushën e bujqësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET QEVERISË SË SHTETIT TË KUVAJTIT DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E BUJQËSISË

Qeveria e Shtetit të Kuvajtit, e përfaqësuar nga Autoriteti Publik për Bujqësinë dhe Burimet Peshkore, dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (më poshtë të quajtura "Palët"),

duke garantuar bashkëpunimin në fushën e bujqësisë, mbrojtjen e bimëve, sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe peshkimit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët kanë rënë dakord të bashkëpunojnë në fushën e bujqësisë midis dy vendeve, si më poshtë:

1. Burimet e bimëve:

- zhvillimi i fidanishteve, mbjelljen pa tokë dhe transferimin e teknologjisë në këtë fushë;
- shkëmbimin e kërkimeve dhe eksperimenteve bujqësore, në lidhje me rritjen e prodhimit;
- trajnimi i stafit në fushën e prodhimit bimor, shkëmbimi i ekspertëve dhe i specialistëve në sektorin e bujqësisë dhe menaxhimi i integruar i burimeve ujore;
- investime të përbashkëta në fushën e bujqësisë.

2. Shëndeti i kafshëve:

- shkëmbimi i ekspertëve;
- shkëmbimi i njohurive, nëpërmjet ndarjes së pamfleteve shkencore, raporteve dhe rezultateve të kërkimeve praktike;
- trajnimi i anëtarëve të stafit të specializuar të të dyja vendeve në qendrat dhe institucionet kërkimore.

Në fushën e prodhimit blegtoral, palët bien dakord të shkëmbejnë ekspertizë, në lidhje me përdorimin e teknikave moderne të tilla si inseminimi artificial, transplant embrioni dhe inxhinieria gjenetike, shkëmbimi i racave lokale, me qëllim studimin e përshtatjes së tyre me mjedisin e ri dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve, duke forcuar kërkesat shëndetësore;

- importimi dhe eksportimi i koncentrateve dhe ushqimit për kafshë ndërmjet dy vendeve.

Në fushën e mjekësisë dhe shërbimeve veterinare, edukimit dhe aplikimit veterinar, palët bien dakord të:

- shkëmbejnë njohuri dhe informacion, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të mjekësisë veterinare dhe promovimin e kualifikimit profesional të veterinerëve;
- shkëmbejnë informacion të specializuar dhe zhvillojnë konsultime dypalëshe.
- shkëmbejnë informacion mbi çështje dhe zbatimin e legjislacionit përkatës në këtë fushë.

3. Siguria ushqimore

- shkëmbejnë njohuri dhe informacion ndërmjet dy vendeve në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit;
- shkëmbimi i ekspertëve nga të dyja palët, me qëllim ndarjen e përvojës dhe njohurive në fushën e testimit laboratorik, duke garantuar standardet më të larta në sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit në të dyja vendet.
- trajnimi i ekspertëve dhe stafit të Drejtorisë së Sigurisë Ushqimore dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në institucione dhe qendra kërkimore të Kuvajtit, duke rritur dhe promovuar njohuritë e avancuara dhe duke zbatuar metodat më të fundit në institucionet e Sigurisë Ushqimore të Shqipërisë.
- Investimi në projekte të prodhimit blegtoral, domethënë të prodhimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, si dhe në: prodhimin e mishit të kuq dhe të bardhë dhe përpunimin e produkteve të tij.

4. Mbrojta e bimëve

- njohja e legjislacionit të mbrojtjes së bimëve të Kuvajtit dhe zhvillimi i tyre institucional;
- shkëmbimi i përvojës në lidhje me masat parandaluese kundër dëmtuesve të bimëve dhe produkteve të bimëve;
- shkëmbimi i përvojës praktike për zbatimin e masave të kontrollit kundër dëmtuesve karantinorë;
- shkëmbimi i informacionit mbi arritjet shkencore në fushën e mbrojtjes së bimëve;
- aplikimi i mjeteve e metodave të duhura për menaxhimin e integruar të dëmtuesve dhe kontrollin e sëmundjeve.

5. Burimet peshkore:

- shkëmbimi i informacioneve shkencore, revistave dhe pamfleteve në fushën e peshkimit, akuakulturës dhe përdorimit të burimeve ujore;
- trajnimi i stafit për mënyrat, mjetet dhe teknikat moderne në kontrollin detar;
- trajnimi mbi metodat moderne të menaxhimit të peshkimit të peshqve cilësorë, karkalecave të detit dhe të mënyrave të vlerësimit të stokut të peshqve;
- bashkëpunimi nëpërmjet projekteve të përbashkëta për rehabilitimin dhe zhvillimin e burimeve peshkore;
- trajnimi i stafit mbi përdorimin e mjeteve shkencore moderne dhe kryerjen e vlerësimit biologjik te peshqit, përdorimin e pajisjeve të analizave hidrologjike dhe analizimin e informacionit. Gjithashtu, shqyrtimi i zooplanktonëve, fitoplanktonëve dhe praktika të tjera të qëndrimit pezull në ujë;
- trajnimi i stafit në teknikat e akuakulturës, diagnostikimit të sëmundjeve të peshqve, metodave të trajtimit të sëmundjeve dhe parandalimit.

6. Kultivimi i peizazhit:

- shkëmbimi i ekspertëve;
- shkëmbimi i informacionit shkencor, revistave dhe pamfleteve në fushën e kultivimit të peizazhit, projekteve të pyllëzimit dhe luleve dekorative;
- shkëmbimi i vizitave për trajnime në veçanti, në lidhje me përdorimin e ujit të trajtuar për ujitje, si edhe në aplikimin teknik në fushën e pyllëzimit, si dhe menaxhimin dhe zhvillimin e zonave pyjore, si zona të parqeve natyrale.

Neni 2

Palët do të punojnë për zbatimin e neneve të Memorandumit të Mirëkuptimit, duke vendosur

afat kohor të rënë dakord nga të dyja Palët nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 3

Palët duhet të përpiqen të:

l. përmirësojnë marrëdhëniet e ndërsjella nëpërmjet programeve të përbashkëta të bashkëpunimit;

2. bashkëpunojnë në kërkime shkencore, ekspertizë dhe teknika për arritjen e objektivave të përparimit të bujqësisë në të dyja vendet;

3. kërkojnë për burime financiare për të gjetur fonde për mbështetjen e projekteve të përbashkëta, për të cilat është rënë dakord nga të dyja vendet.

Neni 4

Nëse Palët bien dakord të shkëmbejnë ekspertë, Pala që dërgon ekspertin duhet të mbulojë kostot e udhëtimit dhe pala pritëse do të mbulojë shpenzimet e jetesës dhe të akomodimit.

Përveç kur palët bien dakord ndryshe, secila Palë do të mbulojë kostot që rrjedhin nga ky Memorandum Mirëkuptimi.

Neni 5

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga zbatimi dhe/ose interpretimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe konsultimeve ose negociatave.

Neni 6

Dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk ndikojnë te ligjet e zbatueshme të të dyja vendeve apo të drejtat ose detyrimet që ka secili nga të dyja vendet nga traktatet dhe konventat ndërkombëtare ku janë palë.

Neni 7

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi datën marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, ku Palët njoftojnë njëra-tjetrën mbi përfundimin e procedurave të tyre të brendshme që kërkohen për hyrjen në fuqi të këtij Memorandumi.

2. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të amendohet në çdo kohë me miratim të ndërsjellë me shkrim të të dyja Palëve. Amendimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni.

3. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të jetë i vlefshëm për një periudhë prej 5 (vjetësh) nga data e hyrjes në fuqi dhe do të rinovohet automatikisht për të njëjtën periudhë apo periudha, përveç kur njëra nga palët njofton palën tjetër me shkrim dhe nëpërmjet kanaleve diplomatike mbi qëllimin e saj për ta përfunduar memorandumin 6 muaj para datës së përfundimit të tij.

4. Përfundimi i këtij Memorandum Mirëkuptimi nuk do të ndikojë në vlefshmërinë ose kohëzgjatjen e marrëveshjeve, projekteve dhe aktiviteteve specifike të kryera në zbatim të këtij Memorandum Mirëkuptimi.

Bërë në qytetin e Tiranës, më 24 mars 2016, në dy kopje origjinale në gjuhët arabisht, shqip dhe anglisht, ku të gjitha tekstet konsiderohen njëlloj autentike, por në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Qeveria e Shtetit të Kuvajtit
Dr. Ali Saleh Al-Omair
Ministër i Punëve Publike dhe ministër i Shtetit i Asamblesë Kombëtare

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
Edmond Panariti
Ministër i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

VENDIM
Nr. 764, datë 20.12.2023

PËR DEKLARIMIN PASURI KULTURORE E PALUAJTSHME "QENDËR HISTORIKE" TË NJË ZONE NË QYTETIN E GJIROKASTRËS, PËRCAKTIMIN E ZONËS MBROJTËSE TË SAJ DHE MIRATIMIN E PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjave "a" dhe "ç", të pikës 3, të nenit 9, dhe të paragrafit "iii", të shkronjës "b", të pikës 3, të nenit

53, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme "Qendër historike" të një zone në qytetin e Gjirokastrës, sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit, në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Përcaktimin e zonës mbrojtëse të "Qendrës historike" të një zone në qytetin e Gjirokastrës, sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit, në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Vendimi nr. 619, datë 7.7.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen qendër historike të një zone në qytetin e Gjirokastrës dhe miratimin e rregullores 'Për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur në qytetin e Gjirokastrës'", shfuqizohet.
5. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartën e "Qendrës historike" dhe zonës mbrojtëse në Gjeoportalin Kombëtar.
6. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Gjirokastër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANI
PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E "QENDRËS HISTORIKE" TË GJIROKASTRËS DHE ZONËS MBROJTËSE TË SAJ

Neni 1
Qëllimi

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e "Qendrës historike" dhe zonës mbrojtëse të qytetit të Gjirokastrës, si dhe përcaktimin e kufijve të saj.

Neni 2
Objekti

Objekti kryesor i këtij plani është:

1. Ruajtja, mbrojtja, konservimi, mirëmbajtja dhe restaurimi i vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkeologjike dhe të peizazhit të "Qendrës historike" të qytetit të Gjirokastrës dhe zonës mbrojtëse përreth saj, sipas hartës së zonifikimit bashkëlidhur.
2. Administrimi i "Qendrës historike" të qytetit të Gjirokastrës dhe zonës mbrojtëse përreth saj.
3. Mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve të specializuara të ngarkuara për ruajtjen, mbrojtjen, restaurimin dhe miradministrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe të peizazhit të "Qendrës historike" të qytetit të Gjirokastrës, me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 3
Hapësira urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje me vlera të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike, arkeologjike dhe të peizazhit të "Qendrës historike" të Gjirokastrës përbëhet nga:
a) "Qendra historike";
b) zona mbrojtëse përreth saj.
2. Brenda këtyre zonave përfshihen ansamble historike, zona të gjelbra, monumente të kategorisë së parë dhe monumente të kategorisë së dytë.
3. Plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Gjirokastrës duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes së zonifikimit të "Qendrës historike" dhe zonës mbrojtëse përreth saj.
4. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e "Qendrës historike", zonës mbrojtëse përreth saj, si dhe të monumenteve të kulturës brenda kësaj hapësire.

Neni 4
"Qendra historike" dhe kufijtë e saj

1. "Qendra historike" e qytetit të Gjirokastrës është hapësira me vlera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike, arkeologjike dhe të peizazhit. Ajo ruan tipologji të ndryshme ndërtimore, si ndërtime mbrojtëse, ndërtime shoqërore, kulti dhe banesa popullore, të cilat janë të lidhura me peizazhin urbanistiko-arkitektonik e tradicional të qytetit të Gjirokastrës.

2. Qendra historike përfshin hapësirën ku ndodhen kalaja, Ansambli i Pazarit të qytetit, pjesë të lagjeve: "Pazar i vjetër", "Pllakë", "Hazmurat", "Teqe", "Varosh", "Meçite", "Palorto", "Dunavat I", "Dunavat II", "Manalat" dhe "Cfakë" dhe zonat e gjelbra, monumente kulture dhe objekte pa status.

3. Kufijtë e "Qendrës historike" paraqiten në hartën e zonifikimit, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

4. Koordinatat në sistemin referues zyrtar "KRGJSH" të "Qendrës historike" paraqiten në aneksin 1, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 5
Zona mbrojtëse e "Qendrës historike" dhe kufijtë e saj

1. Zona mbrojtëse është hapësira që shtrihet përreth "Qendrës historike". Vlera e saj historike-kulturore plotëson, pasuron dhe mbron vlerat e "Qendrës historike". Zona mbrojtëse ruhet në të gjithë përbërësit urbanistikë, arkitektonikë dhe vlerat e peizazhit.

2. Zona mbrojtëse ndahet në dy nënzona, me emërtimet si vijon, sipas hartës së zonifikimit, pjesë e këtij plani:

a) Nënzona I "Zona urbane" përfshin:

i. pjesë të lagjeve "Cfakë", "Manalat", "Dunavat";

ii. pjesë të lagjeve "Palorto", "Varosh";

iii. pjesë të lagjeve "11 Janari", "Hazmurat";

iv. pjesë e lagjes së Punëtorëve;

b) Nënzona II "Zona të gjelbra" përfshin:

v. pjesë të lagjes "Cfakë";

vi. pjesë të lagjes "Partizani";

vii. pjesë të lagjes "11 Janari".

3. Në zonën mbrojtëse përfshihen hapësirat e gjelbërta të lagjeve, monumente kulture dhe objekte pa status, si pjesë e rëndësishme e peizazhit historik të qytetit.

4. Kufijtë e zonës mbrojtëse paraqiten sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit në KRGJSH, pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 6
Ndërhyrjet e lejuara në "Qendrën historike"

1. Ndërhyrjet në "Qendrën historike" kanë si qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike, arkeologjike dhe të peizazhit të qytetit të Gjirokastrës.

2. Brenda kësaj zone lejohen këto ndërhyrje:

a) studime rehabilitimi të imazhit të pjesëve të veçanta të qendrës historike, lidhur me qëndrimin ndaj ndërtimeve, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor cenojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të qendrës. Studimet përcaktojnë objektet ku kryhen punime konservuese, restauruese dhe rikonstruksione, objektet për ritrajtime për të rritur vlerat e tyre, si dhe objektet që cenojnë unitetin arkitekturor të zonës dhe vlerat e nëntokës;

b) ndërhyrje sistematike restauruese, konservuese dhe të mirëmbajtjes, sipas parimeve të konservimit të integruar;

c) në këtë zonë përfshihen edhe objekte me status "Monument kulture", në të cilat lejohen vetëm ndërhyrjet e mirëmbajtjes, konservimit dhe restaurimit;

ç) ruajtja dhe përfshirja e vlerave mjedisore dhe e peizazhit kulturor, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit dhe llojshmërinë e drurëve e të bimësisë tradicionale. Në rast të dukurive natyrore, që ndryshojnë konfigurimin e truallit, ndërhyrjet kryhen sipas legjislacionit në fuqi;

d) konservimi i rrënojave të ndërtimeve me konture të qarta murature, në hapësirën e "Qendrës historike", kur rrënojat ruhen në lartësi mbi 3 m dhe cenojnë dukshëm njësinë e ansambleve, brenda të cilave përfshihen, mund të kryhet rikonstruksioni në të njëjtin vëllim, mbi strukturën ekzistuese (mureve perimetralë), në funksion të ruajtjes së karakteristikave origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, bazuar në materialin arkivor, dokumentacionin e qartë fotografik, grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale të ndërtimit;

dh) në raste fatkeqësish natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, me objektiv primar ruajtjen sa të jetë e mundur të karakteristikave origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, bazuar në materialin arkivor, dokumentacionin e qartë fotografik dhe grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik, si dhe teknikën tradicionale, pas marrjes së miratimit nga IKTK-ja për rindërtimet, mbi përputhshmërinë në volume, ngjyra, materiale me objektet pasuri kulturore.

3. Ndalohen ndërtimet e reja në "Qendrën historike", me përjashtim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore, rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të përmendura më sipër.

Neni 7

Ndërhyrjet e lejuara në zonën mbrojtëse të "Qendrës historike"

1. Nënzonat brenda zonës mbrojtëse i nënshtrohen masave të ndryshme mbrojtëse specifike për secilën, duke u bazuar në karakteristikat dhe gjendjen ekzistuese të secilës zonë.

2. Ndërhyrjet e lejuara në nënzonën I "Zona urbane" janë:

a) Studime rehabilitimi të imazhit të pjesëve të veçanta të zonës mbrojtëse, lidhur me qëndrimin ndaj ndërtimeve, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor cenojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të qendrës. Studimet përcaktojnë objektet ku kryhen punime konservuese, restauruese dhe rikonstruksione apo edhe ndërtime të reja, objektet për ritrajtime për të rritur vlerat e tyre, si dhe objektet që cenojnë unitetin arkitekturor të zonës dhe vlerat e nëntokës;

89	511791.5	4436873
90	511717.9	4436872
91	511664.9	4436852
92	511639.9	4436852
93	511617.9	4436844

94	511571.2	4436843
95	511534.9	4436859
96	511526.9	4436851
97	511508	4436851
98	511507.7	4436873
99	511477.3	4436873
100	511424.5	4436893
101	511388	4436903
102	511355	4436923
103	511346.9	4436932
104	511346.8	4436947
105	511325.2	4436963
106	511325	4436980
107	511320.9	4436994
108	511320.8	4437003
109	511329.8	4437006
110	511337.6	4437001
111	511346.1	4437001
112	511362.5	4437016
113	511376.6	4437023
114	511388.6	4437045
115	511420.4	4437079
116	511440.9	4437100
117	511443.1	4437121
118	511397.7	4437162
119	511366.2	4437169
120	511316.2	4437197
121	511286.9	4437212
122	511251.7	4437239
123	511157	4437278
124	511137	4437299
125	511126.2	4437331
126	511125.9	4437355
127	511129.7	4437378
128	511144	4437389
129	511159.3	4437392
130	511170.8	4437396
131	511225.4	4437427
132	511247.6	4437420
133	511291.9	4437423
134	511329	4437416
135	511372.7	4437416
136	511379	4437437
137	511424.4	4437447
138	511420.3	4437411
139	511431.5	4437403
140	511447.6	4437404

141	511453.6	4437401
142	511461	4437389
143	511486.2	4437363
144	511489.5	4437339
145	511528.8	4437309
146	511533.6	4437299
147	511535.8	4437288
148	511544	4437268
149	511562.1	4437243
150	511641.4	4437235
151	511796.1	4437242
152	511817.7	4437221
153	511857.1	4437258
154	511865.3	4437336
155	511931.6	4437385
156	511965.7	4437359
157	511980	4437395
158	511984.1	4437412
159	512016.4	4437433
160	512031.7	4437432
161	512061.9	4437454
162	512063.5	4437458
163	512103.4	4437473
164	512109.5	4437474
165	512114.6	4437476
166	512116.5	4437480
167	512117.8	4437485
168	512122.2	4437491
169	512130.4	4437494
170	512148.8	4437500
171	512174	4437510
172	512207.6	4437527
173	512229.8	4437535
174	512294.2	4437565
175	512297	4437579
176	512303.9	4437593
177	512308.7	4437606
178	512320.6	4437610
179	512330.4	4437618
180	512340.4	4437620
181	512362.5	4437617
182	512374.8	4437619
183	512389.5	4437626
184	512397	4437632
185	512402.1	4437643
186	512398.9	4437648
187	512391.2	4437654

188	512417.4	4437698
189	512368.3	4437727
190	512358.2	4437729
191	512344.3	4437730
192	512317.3	4437740
193	512327.2	4437758
194	512347.8	4437775
195	512353.6	4437786
196	512355.3	4437801
197	512370.3	4437812

Koordinatat e Nënzonës 1d

NR	X	Y
1	511875.9	4438168
2	511866.8	4438164
3	511859.1	4438160
4	511847.9	4438158
5	511837.1	4438162
6	511832.1	4438166
7	511829.7	4438171
8	511823.1	4438172
9	511816.2	4438182
10	511811.9	4438193
11	511805.9	4438204
12	511798.5	4438210
13	511787.7	4438217
14	511772.7	4438220
15	511763.6	4438216
16	511759	4438212
17	511754.5	4438207
18	511747.6	4438189
19	511742.4	4438181
20	511737.1	4438170
21	511730.4	4438151
22	511723.7	4438133
23	511718.6	4438131
24	511703.8	4438129
25	511704.9	4438119
26	511718.2	4438076
27	511701.3	4438073
28	511688.7	4438063
29	511671.2	4438049
30	511668.4	4438047
31	511634.5	4438016
32	511615.5	4438026
33	511608	4438022
34	511595.3	4438018
35	511589.3	4438009
36	511584.4	4438007
37	511574.5	4438007
38	511543.8	4438019
39	511531.6	4438022
40	511442.4	4438076
41	511425.4	4438059
42	511401.8	4438032
43	511342.4	4437979
44	511329.8	4437968
45	511325.1	4437946
46	511330.2	4437929

47	511322.7	4437920
48	511357.4	4437897
49	511389.6	4437881
50	511361.8	4437857
51	511400.4	4437819
52	511449.9	4437783
53	511482.6	4437771
54	511509.8	4437763
55	511507.6	4437750
56	511494.2	4437711
57	511534.4	4437686
58	511534.6	4437669
59	511527.1	4437657
60	511509.1	4437684
61	511500.1	4437696
62	511494.7	4437699
63	511480.8	4437707
64	511458.1	4437717
65	511444.2	4437724
66	511425	4437737
67	511416.7	4437743
68	511382.3	4437771
69	511378.7	4437772
70	511359.6	4437780
71	511322.3	4437791
72	511279.4	4437807
73	511250.3	4437819
74	511221.9	4437831
75	511188.6	4437849
76	511144.6	4437876
77	511171.7	4437911
78	511197.9	4437928
79	511197.5	4437956
80	511207	4437963
81	511206.9	4437974
82	511213.4	4437986
83	511197.6	4438004
84	511181.7	4438041
85	511173.6	4438065
86	511155.8	4438090
87	511146.5	4438107
88	511161.9	4438120
89	511167.2	4438128
90	511153.8	4438155
91	511153.6	4438172
92	511184	4438184
93	511202.8	4438201

94	511215.4	4438216
95	511231.7	4438228
96	511251.8	4438228
97	511262.1	4438237
98	511276.6	4438273
99	511287.1	4438279
100	511297.9	4438283
101	511307.2	4438287
102	511317.2	4438293
103	511356	4438308
104	511372.7	4438307
105	511385.6	4438307
106	511401.2	4438303
107	511419.9	4438303
108	511433.5	4438305
109	511449.7	4438304
110	511473.7	4438302
111	511490	4438299
112	511511.3	4438295
113	511522.3	4438292
114	511534.3	4438287
115	511552.5	4438278
116	511587.5	4438275
117	511594.9	4438248
118	511631.3	4438191
119	511678	4438228
120	511708.2	4438224
121	511734.9	4438217
122	511761.6	4438266
123	511803.8	4438265
124	511814.3	4438262
125	511818.5	4438257
126	511827.5	4438241
127	511857.7	4438205
128	511861.3	4438199
129	511865.4	4438191
130	511872.7	4438174
131	511875.9	4438168

Koordinatat e Nënzonës 2a

OBJECTID_	X	Y
1	511527.1	4437657
2	511524.9	4437653
3	511524.4	4437638
4	511516.4	4437612
5	511516.9	4437575
6	511531.1	4437517
7	511538.1	4437503
8	511572.5	4437504
9	511582.4	4437480
10	511588.9	4437447
11	511532.8	4437449
12	511475.7	4437460
13	511462.8	4437458
14	511424.4	4437447
15	511379	4437437
16	511394.4	4437489
17	511384.5	4437514
18	511366.8	4437542
19	511357.6	4437573
20	511347.3	4437629
21	511314	4437660
22	511291.5	4437683
23	511271.6	4437709
24	511264.5	4437725
25	511247.4	4437725
26	511207.8	4437763
27	511145	4437839
28	511144.6	4437876
29	511188.6	4437849
30	511221.9	4437831
31	511250.3	4437819
32	511279.4	4437807
33	511322.3	4437791
34	511359.6	4437780
35	511378.7	4437772
36	511382.3	4437771
37	511416.7	4437743
38	511425	4437737
39	511444.2	4437724
40	511458.1	4437717
41	511480.8	4437707
42	511494.7	4437699
43	511500.1	4437696
44	511509.1	4437684
45	511527.1	4437657

Koordinatat e Nënzonës 2b

NR	X	Y
1	512217.1	4438415
2	512209.1	4438415
3	512177.3	4438389
4	512130.3	4438337
5	512123.5	4438317
6	512106.8	4438297
7	512078.9	4438279
8	512055.1	4438270
9	512031.4	4438250
10	512029.5	4438229
11	512020.9	4438219
12	511997.2	4438218
13	511975	4438216
14	511929	4438143
15	511915.2	4438140
16	511907.7	4438155
17	511902.8	4438159
18	511889.3	4438163
19	511875.9	4438168
20	511872.7	4438174
21	511865.4	4438191
22	511861.3	4438199
23	511857.7	4438205
24	511924	4438229
25	511947.9	4438215
26	512043.1	4438311
27	512085.9	4438346
28	512166.5	4438431
29	512282.1	4438475
30	512242.5	4438440
31	512225.8	4438430
32	512217.1	4438415

Koordinatat e Nënzonës 2c

NR	X	Y
1	512499.5	4437959
2	512490	4437938
3	512486	4437915
4	512485.7	4437894
5	512483.3	4437875
6	512483.5	4437858
7	512491.9	4437813
8	512500.2	4437779
9	512489	4437744
10	512492.2	4437741
11	512473.4	4437717
12	512482.5	4437710
13	512480.4	4437707
14	512457	4437676
15	512454.1	4437677
16	512449.2	4437678
17	512441.7	4437683
18	512432.6	4437689
19	512447.5	4437712
20	512427.8	4437724
21	512438.2	4437739
22	512417.4	4437756
23	512426.2	4437773
24	512370.3	4437812
25	512371.2	4437817
26	512371.8	4437829
27	512377.5	4437864
28	512380.2	4437900
29	512378.3	4437914
30	512379.5	4437914
31	512387	4437917
32	512396	4437920
33	512410.1	4437929
34	512415.3	4437939
35	512414.1	4437950
36	512412.9	4437964
37	512429.2	4437973
38	512444.5	4437984
39	512452.2	4437998
40	512446.5	4438009
41	512444.5	4438021
42	512443.4	4438035
43	512451.9	4438064
44	512458	4438079
45	512463.1	4438091
46	512489	4438086

47	512493	4438086
48	512497.1	4438089
49	512506.8	4438103
50	512520.2	4438116
51	512524.9	4438100
52	512514.7	4438066
53	512517.8	4438048
54	512518.1	4438022
55	512499.4	4437968
56	512499.5	4437959

Koordinatat e Nënzonës 2d

NR	X	Y
1	512304.1	4438304
2	512333.6	4438257
3	512343.8	4438257
4	512351.1	4438246
5	512354.2	4438239
6	512334.4	4438209
7	512339.2	4438208
8	512340	4438204
9	512336.3	4438201
10	512329.5	4438194
11	512323.5	4438173
12	512323.9	4438158
13	512325.3	4438152
14	512334.7	4438152
15	512347.1	4438151
16	512355	4438147
17	512359.5	4438142
18	512353.1	4438142
19	512338.7	4438138
20	512330.6	4438134
21	512325.3	4438127
22	512317.9	4438112
23	512309	4438099
24	512292.3	4438085
25	512273.5	4438073
26	512252.7	4438055
27	512240	4438046
28	512223.5	4438038
29	512207.1	4438034
30	512175.5	4438031
31	512152.6	4438025
32	512144.4	4438020
33	512138.4	4438015
34	512134.1	4438008
35	512129.1	4437996
36	512122.1	4437981
37	512122	4437986
38	512106.8	4438024
39	512105.3	4438024
40	512098.6	4438023
41	512087.8	4438026
42	512051.7	4438028
43	512022.6	4438020
44	512022	4438022
45	512034.7	4438036
46	512037.5	4438043

47	512041.5	4438059
48	512062.2	4438088
49	512071	4438108
50	512092.5	4438132
51	512098.2	4438149
52	512158.5	4438204
53	512203.9	4438269
54	512208.1	4438278
55	512215.3	4438301
56	512237.6	4438342
57	512255.6	4438349
58	512259.3	4438353
59	512265.2	4438365
60	512265.6	4438367
61	512266.2	4438367
62	512282.1	4438358
63	512280	4438355
64	512277.5	4438349
65	512277.3	4438335
66	512280	4438329
67	512304.1	4438304

VENDIM
Nr. 766, datë 20.12.2023

PËR SHPËRBLIMIN E DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA, PËR VITIN 2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë shpërblim financiar për vitin 2023, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë familjet me fëmijë të grupmoshës 0–18 vjeç, përfitues të skemës së ndihmës ekonomike, fëmijët me aftësi të kufizuara, përfitues të skemës së aftësisë së kufizuar, dhe fëmijët pa kujdes prindëror të vendosur në familje alternative, sipas ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

2. Përfitojnë shpërblim financiar për vitin 2023, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, përfituesit e ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

a) Familjet e tjera, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike;

b) Personat me aftësi të kufizuara, sipas shkronjave "b" dhe "c", të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë";

c) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar;

ç) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 939 500 000 (nëntëqind e tridhjetë e nëntë milionë e pesëqind mijë) lekë dhe përballohen nga fondi i kontingjencës, miratuar për vitin 2023.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 745, datë 14.12.2023

PËR PËRDITËSIMIN E URDHRIT TË MINISTRIT NR. 275, DATË 5.5.2023, "PËR MIRATIMIN E LËNDËVE VEPRUESE DHE PËRBËRËSVE TË TJERË, NË PËRMBAJTJE TË PMB-ve", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar, si dhe të pikës 6.3, të kreut VII, të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar, dhe sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 275, datë 5.5.2023, "Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve", të ndryshuar, bëhet përditësimi me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) rinovohet regjistrimi për 3 (tre) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

b) zgjaten afatet e regjistrimit për 28 (njëzet e tetë) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

c) hiqen 2 (dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ky përditësim të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

1. RINOVOHET REGJISTRIMI (RIREGJISTRIM) PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	**Glyphosate** CAS No: 1071-83-6 CIPAC No: 284	N-(phosphonomethyl) glycine	≥ 950 g/kg Papastërtitë e mëposhtme janë një shqetësim toksikologjik dhe nuk duhet të kalojnë nivelet e mëposhtme në materialin teknik: - N-nitrozo-glifosat (NNG):< 1 mg/kg; - formaldehid: < 1 g/kg; - trietilaminë: ≤ 2 g/kg; - acid formik: ≤ 4 g/kg; - N,N-bis (fosfonometil) glicine (glifozine): ≤ 3 g/kg.	16 dhjetor 2023	15 dhjetor 2033	Mund të regjistrohet përdorimi vetëm si herbicid. Përdorimet për tharje për të kontrolluar kohën e vjeljes ose për të optimizuar shirjen nuk do të autorizohen. Në vlerësimin e përgjithshëm duhet të kushtohet vëmendje e veçantë për: - bashkëformulantët e pranishëm në produktet e mbrojtjes së bimëve që përmbajnë glifosat, duke marrë parasysh veçanërisht kriteret për identifikimin e bashkëformulantëve të papranueshëm, siç përcaktohet në urdhrin e ministrit nr. 275, datë 5.5.2023, "Për miratimin e substancave aktive dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtjen e PMB-ve", të ndryshuar; - vlerësimin e ekspozimit të konsumatorit në lidhje me mbetjet që mund të jenë të pranishme në kulturat pasardhëse të kultivuara në qarkullim; - mbrojtjen e ujërave nëntokësore në zonat e cenueshme dhe të ujërave sipërfaqësore, veçanërisht ato që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm, duke marrë parasysh

						përdorimet specifike në sipërfaqe të mbyllura; - mbrojtjen e gjitarëve të vegjël barngrënës. Kur konsiderohet e nevojshme, vendosin masa zbutëse të tilla si kufizimi i kohës së përdorimit, numri i aplikimeve ose norma maksimale e dozës. Normat maksimale të mëposhtme të aplikimit nuk duhet të tejkalohen nëse rezultati i vlerësimit të rrezikut të ndërmarrë për përdorimet specifike, për të cilat aplikohet regjistrimi tregon se një normë më e lartë nuk çon në ndonjë efekt të papranueshëm për gjitarët e vegjël barngrënës: - për përdorim në bujqësi: 1,44 kg glifosat/ha/vit; - për përdorim për të kontrolluar b. e dëmshme në zonat bujqësore dhe jobujqësore: 1,8 kg glifosat/ha/vit; - për përdorim në zonat jobujqësore: 3,6 kg glifosat/ha/vit; - mbrojtjen e bimëve tokësore dhe ujore jo të synuara, nga ekspozimi me anë të spërkatjes; - efektet indirekte në biodiversitet nëpërmjet ndërveprimeve trofike, pasi metodat dhe udhëzimet përkatëse për identifikimin e efekteve të tilla janë miratuar. Në mungesë të këtyre metodave dhe udhëzimeve, mund të aplikohen metoda që konsiderohen të përshtatshme për të përcaktuar efektet e mundshme indirekte të PMB-ve që përmbajnë glyphosate dhe që marrin parasysh kushtet e tyre lokale agro-mjedisore. Kur bëhet kjo, nëse identifikohet ndonjë efekt i tillë i mundshëm i tërthortë në biodiversitet, vendosen kushte ose kufizime specifike të përdorimit për PMB-të që përmbajnë glyphosate, duke marrë parasysh veçanërisht nëse ekzistojnë metoda praktike alternative të kontrollit ose parandalimit me ndikim më të ulët në biodiversitet; - përdorimet nga përdorues joprofesionistë; - pajtueshmërinë e përdorimeve para vjeljes. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, duke përfshirë kombinimet e tyre, sipas nevojës. Në veçanti, zhvendosja do të reduktohet për aplikimet me spërkatje të bëra nga përdorues profesionistë në fushat bujqësore. Si parazgjedhje, për të mbrojtur bimët tokësore jo të synuara, një rrip tampon pa spërkatje në fushë prej të paktën 5–10 m nga kufiri i fushës, në varësi të përdorimit të veçantë dhe sprucatorët e zvogëlimit të lëvizjes që reduktojnë lëvizjen e spërkatjes me të paktën 75%, ose do të kërkohen masa të tjera për zbutjen e rrezikut me reduktim ekuivalent të lëvizjes, përveç nëse rezultati i vlerësimit të rrezikut të ndërmarrë për përdorimin e PMB-së tregon se masa të tilla

						zbutëse të rrezikut nuk janë të nevojshme ose mund të ulen sepse nuk ka rreziqe të papranueshme të shkaktuara nga spërkatja. Të sigurohet që përdorimi i PMB-ve që përmbajnë glifosat të minimizohet ose ndalohet në zonat specifike të listuara në VKM-në nr. 317, datë 15.5.2019, "Për miratimin e rregullave për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesit".
2	**Aluminium ammonium sulfate** (dodecahydrate) *CAS No*: 7784-26-1 CIPAC No: 840	Aluminium ammonium sulfate	975 g/kg. Anhydrous - Jo më pak se 510 g/kg; Pa papastërti përkatëse 975 g/kg.	1 shkurt 2024	31 janar 2039	Në vlerësimin e përgjithshëm duhet të kushtohet vëmendje e veçantë për: - mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve aty ku është e nevojshme, duke siguruar që kushtet e përdorimit përfshijnë aplikimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale; - mbrojtjen e organizmave ujorë kur substanca aplikohet në rajone me kushte toke acide ose bazike; - mbrojtjen e bletëve nga aplikimet me spërkatje gjatë periudhës së lulëzimit të fushave ngjitur ose kur barërat e këqija janë të pranishme në fushën e trajtuar; - mbrojtjen e ujërave nëntokësore, kur substanca aplikohet në rajone me tokë dhe/ose kushte klimatike të cenueshme (d.m.th. situata kur pH i tokës është më i ulët se 5,5, p.sh.: livadhet në zonat malore, zonat e pylltarisë halore dhe zonat e bimëve dekorative erikale në rritje); - autorizimin, për përdorim në kulturat e rreshtuara dhe të kombinueshme, si trajtim pengues vetëm në skajet e arave. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut aty ku është e nevojshme.
3	**Ethephon** CAS No: 16672-87-0 CIPAC No: 373	2-chloroethylphosphonic acid	≥ 692 g/kg (TK) ≥ 910 g/kg (TC, theoretical) Papastërtitë e mëposhtme janë një shqetësim toksikologjik dhe nuk duhet të kalojnë nivelet e mëposhtme në materialin teknik: TK: 1,2-dichloroethane < 0,3 g/kg; 2-chloroethanol < 0,3 g/kg. TC (theoretical): 1,2-dichloroethane < 0,5 g/kg; 2-chloroethanol < 0,3 g/kg.	1 shkurt 2024	31 janar 2039	Në vlerësimin e përgjithshëm duhet të kushtohet vëmendje e veçantë për: - mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke siguruar që kushtet e përdorimit përfshijnë aplikimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale; - mbrojtjen e kalimtarëve dhe banorëve, duke siguruar që kushtet e përdorimit përfshijnë përdorimin e pajisjeve për reduktimin e lëvizjes gjatë aplikimit. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e përshtatshme.

2. ZGJATEN AFATET E REGJISTRIMIT PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

- **Deri më 31 dhjetor 2024:**

1. 8-hydroxyquinoline

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- **Deri më 15 prill 2025:**

1. Sulphur

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- **Deri më 15 gusht 2025:**
1. Amidosulfuron
2. Lenacil
3. Fenoxaprop-P
4. Paraffin oil
Gjithsej: 4 (katër) lëndë vepruese.

- **Deri më 15 janar 2026:**
1. Diflufenican
Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- **Deri më 15 mars 2026:**
1. Difenoconazole
Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- **Deri më 31 maj 2026:**
1. Prohexadione
2. Spiroxamine
3. 1-naphthylacetamide
4. 1-naphthylacetic acid
5. Fluazifop P
6. Fenpyrazamine
7. Esfenvalerate
Gjithsej: 7 (shtatë) lëndë vepruese.

- **Deri më 15 tetor 2026:**
1. Dimethachlor
2. Penconazole
Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.

- **Deri më 31 mars 2027:**
1. Nicosulfuron
2. Dicamba
3. Bifenox
4. Etofenprox
5. Tri-allate
6. Tetraconazole
7. Paraffin oils
8. Napropamide
Gjithsej: 8 (tetë) lëndë vepruese.

- **Deri më 15 maj 2027:**
1. Fenpropidin
Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- **Deri më 15 nëntor 2027:**
1. 2-phenylphenol (duke përfshirë kripërat e tij si kripa e natriumit)
Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- **Deri më 15 shkurt 2028:**
1. Picloram
Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

Totali: 28 (njëzet e tetë) lëndë vepruese.

2. HIQEN LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:
1. Triflusulfuron-methyl
Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *triflusulfuron-methyl*, brenda datës 20 shkurt 2024.
Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *triflusulfuron-methyl*, të përfundojë brenda datës 20 gusht 2024.

2. Benthiavalicarb
Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *benthiavalicarb*, brenda datës 13 qershor 2024.
Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *benthiavalicarb*, të përfundojë brenda datës 13 dhjetor 2024.
Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.

VENDIM
Nr. 58, datë 13.11.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 13.11.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (M) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Mimoza Bruzia, përfaqësuar nga avokat Aqif Peza, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1730, datë 20.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1522, datë 24.11.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-1513, datë 22.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Baza Ligjore: Nenet 30, 31, 32, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i", 142, pika 1 dhe 146, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 5 dhe 6, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:
I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Mimoza Bruzia ka ushtruar detyrën e specialistes së ngarkuar me vlera pranë arkës për veprim në Bankën e Shqipërisë, në periudhën 2009–2014. Në datën 21.7.2014, Banka e Shqipërisë ka depozituar një kallëzim kundër shtetasit A. B., me

detyrë përgjegjës i arkës për veprim, me akuzën e përvetësimit të një shume të konsiderueshme parash. Gjatë hetimit ka rezultuar se për këto fakte ka pasur dijeni edhe kërkuesja, e cila ka lejuar shtetasin A. B. të vijojë veprimet e paligjshme gjatë kohës që ushtronte detyrën, por edhe pas largimit të tij. Për pasojë, në datën 24.7.2014, ndaj saj është vendosur masa e sigurimit personal "Arresti në burg".

2. Në përfundim të hetimeve, prokuroria ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të shtetasit A. B. dhe kërkueses, me akuzën e kryerjes së veprës penale "Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit", të parashikuar nga neni 136, paragrafi 2, i Kodit Penal (*KP*), me dyshimin se kjo e fundit ka bashkëpunuar me shtetasin A. B. për të kryer vjedhjen gjatë një afati kohor prej 4 vjetësh.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila e ka shqyrtuar çështjen sipas ritit të gjykimit të shkurtuar, në bazë të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), në përfundim, me vendimin nr. 1730, datë 20.5.2015, ka vendosur deklarimin fajtore të kërkueses për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 136, paragrafi 2, i KP-së dhe dënimin e saj me 10 vjet burgim. Ajo gjykatë, në analizë të fakteve dhe provave, ka arritur në konkluzionin se janë konsumuar plotësisht elementet e veprës penale për të cilën akuzohet kërkuesja, e cila, me veprime konkludente, ka lejuar që shtetasi A. B. të vazhdojë për disa vjet vjedhjen e parave, pavarësisht se detyra e saj ishte administrimi i këtyre vlerave monetare. Edhe pse kërkuesja ka pasur dijeni për këtë veprimtari, e ka lejuar të pandehurin tjetër të futet në ambientet e arkës edhe pasi ai ishte larguar nga detyra. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesja dhe i pandehuri tjetër, shtetasi A. B.

4. Gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes në themel në Gjykatën e Apelit Tiranë, në seancën e datës 24.11.2016, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, përmes një kërkese me shkrim nga mbrojtësi i saj, kërkuesja i ka kërkuar gjykatës të konstatojë humbjen e fuqisë së masës së sigurimit personal "Arresti në burg", me pretendimin se ndodhej në kushtet e shkronjës "c", të pikës 3, të nenit 263 të KPP-së, i cili parashikon se paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë kanë kaluar 9 muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm pa u dhënë vendimi i dënimit në gjykatën e apelit. Gjykata e apelit ka çmuar të mos shprehej në atë moment procedural për bazueshmërinë ose jo të kërkesës, por të vijonte me shqyrtimin e çështjes, me arsyetimin se përgjigjja e kësaj kërkese varej nga përfundimi i gjykimit dhe zgjidhja në themel e çështjes. Ndërkohë, po në këtë seancë gjyqësore, gjykata e apelit ka përfunduar gjykimin në themel të çështjes, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se ai ishte i drejtë, i bazuar në prova dhe ligj. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë edhe kërkuesja.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1513, datë 22.11.2022, ka vendosur mospranimin e rekurseve, përfshirë edhe atë të kërkueses, me arsyetimin se shkaqet e paraqitura në to nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e gjykatave të faktit, në kuptim të nenit 432 të KPP-së. Sipas atij kolegji, në rastin në shqyrtim, nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit penal nga gjykatat më të ulëta dhe ato nuk kanë bërë shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit, sipas nenit 128 të KPP-së, ose shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit në dëm të kërkueses.

6. Në datën 16.3.2023, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në këtë Gjykatë në datën 28.3.2023. Kolegji i Gjykatës në datën 31.5.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e gjykatave i kanë cenuar:

7.1. *Lirinë personale*, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, pasi ajo ka qëndruar në paraburgim nga data 20.5.2015, në të cilën është dhënë vendimi i fajësisë në gjykatën e shkallës së parë, deri në datën 24.11.2016, kur është dhënë vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, duke u tejkaluar afati ligjor 9-mujor, i parashikuar nga neni 263, paragrafi 3, shkronja "c", i KPP-së. Gjykata e Apelit nuk është shprehur në seancë me vendim të ndërmjetëm për rrëzimin e

kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit "Arresti në burg" dhe as në vendimin përfundimtar. Edhe Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka pranuar se periudha e paraburgimit gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit e ka tejkaluar afatin ligjor 9-mujor të përcaktuar në dispozitën e mësipërme.

7.2. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.2.1. Së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit substancial, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të paraqitura në rekurs, të cilat kishin të bënin me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor. Gjykata e Lartë duhej t'i analizonte këto pretendime dhe jo të vendoste mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit.

7.2.2. Së drejtës për t'u mbrojtur dhe asaj për t'u dëgjuar, pasi nisur nga fakti se kërkuesja ka ngritur pretendime në lidhje me kualifikimin e drejtë të veprës penale, Gjykata e Lartë duhej ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, me praninë e palëve.

7.2.3. Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi gjykatat janë nisur nga karakteri sensitiv i çështjes dhe kanë dhënë një vendim të padrejtë. Megjithëse ato kanë pranuar se kërkuesja ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 i KP-së, në përfundim e kanë dënuar atë për veprën penale "Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit", të parashikuar nga neni 136, paragrafi 2, i KP-së. Gjatë gjykimit të çështjes nuk është provuar që kërkuesja të ketë kryer veprën penale në bashkëpunim, pasi në referim të dispozitave penale dhe vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë mungon elementi i marrëveshjes midis personave që kanë kryer veprën penale.

7.2.4. Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi gjykimi i çështjes penale në ngarkim të kërkueses ka filluar në vitin 2015 dhe ka përfunduar në datën 22.11.2022, pra ka zgjatur për më shumë se 7 vjet, duke tejkaluar çdo afat të parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile (*KPC*).

8. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, ka prapësuar se:

8.1. Pretendimi për cenimin e *lirisë personale* është i pabazuar. Gjykata e apelit ka vlerësuar se nuk ka shkak për zëvendësimin e masës së sigurimit "Arresti në burg". Edhe pse afati i paraburgimit, sipas nenit 263, paragrafi 3, shkronja "c", të KPP-së kishte përfunduar, kërkuesja i është drejtuar me kërkesë gjykatës së apelit vetëm në 24.11.2016, në seancën e parë të gjykimit të themelit të çështjes së saj. Kujdesi për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit u përket të gjitha subjekteve të procedimit, por në veçanti subjektit që i cenohen ato. Në këtë kuptim, për periudhën nga data e kalimit të afatit dhe deri ditën e gjykimit të çështjes, kërkuesja nuk ka kërkuar lirimin nga paraburgimi, duke mos ngritur pretendime për cenimin e lirisë personale, ndaj ajo nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion përpara ngritjes së një pretendimi të tillë në nivel kushtetues. Pretendimi i kërkueses ka marrë përgjigje edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë, e cila është shprehur se me shpalljen e vendimit të gjykatës së apelit, masa e sigurimit ndaj kërkueses, gjithsesi, është shuar për shkak të ligjit, ndërsa ajo ka marrë statusin e të dënuarës dhe tashmë qëndron në burgim dhe jo paraburgim, çka bën të pamundur lirimin e saj mbi shkakun e humbjes së fuqisë së paraburgimit në kuptim të nenit 263, paragrafi 3, shkronja "c", të KPP-së, ndërkohë që periudha e paraburgimit përllogaritet në masën e dënimit që ajo duhet të shlyejë. Gjykatat kanë konstatuar qëndrimin në paraburgim të kërkueses tej afatit ligjor 9-mujor të përcaktuar në dispozitën në fjalë, duke u shprehur edhe për mënyrën e rivendosjes së të drejtës së shkelur asaj, pikërisht përmes llogaritjes, sipas përcaktimeve të nenit 57 të KP-së, edhe të kësaj periudhe paraburgimi në masën e dënimit që ajo duhet të vuajë.

8.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit dhe së drejtës së ankimit substancial*, është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka analizuar dhe kthyer përgjigje edhe për themelin e pretendimeve të kërkueses, duke vendosur mospranimin e rekursit për shkak të mungesës së shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Vendimi paraqitet i qartë dhe pa kundërthënie dhe pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat, shkaqet e rekursit dhe pjesa arsyetuese është në harmoni me konkluzionin se në rastin konkret nuk ka mosrespektim të ligjit penal nga gjykatat e faktit.

8.3. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar*, argumentet e kërkueses nuk lidhen me kuptimin që jurisprudenca kushtetuese i jep kësaj të drejte dhe nuk konstatohet asnjë e dhënë që lidhet me institutin e mbrojtjes efektive. Pretendimet e parashtruara në rekurs janë arsyetuar nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të kërkueses,

duke realizuar në këtë mënyrë të drejtën për mbrojtje efektive.

8.4. Pretendimin për cenimin e së *drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme* kërkuesja e ka bazuar vetëm në natyrën sensitive të çështjes, duke mos e argumentuar mjaftueshëm se si është cenuar kjo e drejtë. Pretendimet e saj, gjithashtu, janë me natyrë ligjore dhe nuk i përkasin juridiksionit kushtetues, për rrjedhojë ajo nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi nuk ka arritur t'i ngrejë ato në nivel kushtetues.

8.5. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së *drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, pasi në kuptim të neneve 399/1–399/12 të KPC-së, kërkesa për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin bëhet nga gjykatat e zakonshme dhe jo drejtpërdrejt në Gjykatë. Vonesa në gjykimin e çështjes ka ardhur si pasojë e pamundësisë objektive të gjykimit për shkak të akumulimit të përkohshëm të çështjeve dhe mungesës së kapaciteteve njerëzore për përballimin e kësaj situate.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Në këtë këndvështrim, kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë *(shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 12, datë 24.5.2022; nr. 5, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

12. Kërkuesja ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi gjykimi i çështjes penale në ngarkim të saj ka filluar në vitin 2015 dhe ka përfunduar në datën 22.11.2022 (me vendimin e Gjykatës së Lartë), pra për më shumë se 7 vjet, duke tejkaluar afatet e parashikuara nga KPC-ja që përcaktojnë kohëzgjatjen e arsyeshme. Gjykata vëren se ky pretendim është parashtruar për herë të parë drejtpërdrejt përpara saj, duke mos shteruar kërkuesja, paraprakisht, mjetet juridike efektive që ofron legjislacioni në fuqi, në kuptim të parashikimeve të neneve 399/1–399/12 të KPC-së. Sipas jurisprudencës kushtetuese, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit, duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon ky kod, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se për këtë pretendim kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000.

13. Ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera në ankimin kushtetues individual, për cenimin e lirisë personale dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor në disa aspekte të saj, Gjykata vëren se kërkuesja i ka ngritur më parë në formë dhe në substancë përpara gjykatave të zakonshme, për rrjedhojë konsiderohet se e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

14. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 22.11.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 16.3.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e lirisë personale, si dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit dhe të ankimit substancial, së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar, si dhe së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.

16. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, Gjykata çmon se kërkuesja ka argumentuar se gjykatat janë nisur nga karakteri sensitiv i çështjes dhe se kanë dhënë një vendim të padrejtë, por pa arritur ajo të provojë nga pikëpamja kushtetuese cenimin e kësaj të drejte në aspektin objektiv ose subjektiv të saj. Vetëm fakti se gjykatat, në përfundim të gjykimit, kanë vendosur deklarimin fajtore dhe dënimin e kërkueses për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohej, nuk është i mjaftueshëm për të mbështetur këtë pretendim, në kushtet kur vendimmarrja e gjykatave të zakonshme është rezultat i vlerësimit të fakteve dhe provave të administruara dhe interpretimit e zbatimit të ligjit procedural e material penal. Për rrjedhojë, kërkuesja nuk ka paraqitur argumente kushtetuese në mbështetje të tij. Po në drejtim të këtij pretendimi, argumentet e kërkueses se nuk është provuar që të ketë kryer veprën penale në bashkëpunim, pasi mungon elementi i marrëveshjes midis personave që kanë kryer veprën penale, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të fakteve dhe rrethanave të rastit, që përfshihen në kompetencat e gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues.

17. Për sa u përket pretendimeve të kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të ankimit substancial, si dhe të së drejtës për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar, mbështetur në natyrën e tyre dhe thelbin e argumenteve, Gjykata çmon t'i trajtojë në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit. Ky pretendim, ashtu si edhe pretendimi për cenimin e lirisë personale, hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj bazueshmëria e tyre në themel do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale

18. Sipas kërkueses, ajo ka qëndruar në paraburgim përtej afatit 9-mujor të parashikuar në nenin 263, paragrafi 3, shkronja "c", të KPP-së, në pritje të gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit. Sipas saj, paraburgimi ka humbur fuqinë pas kalimit të këtij afati të llogaritur nga data 20.5.2015 e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë, në kushtet e mosgjykimit të çështjes nga gjykata e apelit, e cila, në fakt, e ka dhënë vendimin e saj mbas 18 muajve, në datën 24.11.2016. Gjykata e Apelit Tiranë nuk është shprehur në seancë me vendim të ndërmjetëm për rrëzimin e kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit "Arresti në burg" dhe as në vendimin përfundimtar. Qëndrimi në paraburgim, tej afatit ligjor 9-mujor, në pritje të gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, është pranuar edhe nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj.

19. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi gjykata e apelit nuk mund të shprehej menjëherë për kërkesën e kërkueses për shuarjen e masës së sigurimit, ndërkohë që në vendimin e saj përfundimtar, pasi ka vlerësuar se një kërkesë e tillë është paraqitur në të njëjtën ditë kur gjykohej çështja e themelit dhe për sa kohë arrinte në përfundimin se vendimi i dënimit i gjykatës së shkallës së parë për kërkuesen duhet të lihej në fuqi, ajo është shprehur se nuk ka shkak për zëvendësimin e masës së sigurimit "Arresti në burg", sepse vendimi i saj është i formës së prerë dhe menjëherë i ekzekutueshëm. Kujdesi për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit u përket të gjitha subjekteve të procedimit, por në veçanti subjektit që i cenohen ato. Në këtë kuptim, për periudhën nga data e kalimit të afatit dhe deri ditën e gjykimit të çështjes, kërkuesja nuk ka kërkuar lirimin nga paraburgimi, duke mos ngritur pretendime për cenimin e lirisë personale, ndaj ajo nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion përpara ngritjes së një pretendimi të tillë në nivel kushtetues. Pretendimi i kërkueses ka marrë përgjigje edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë, e cila është shprehur se me shpalljen e vendimit të gjykatës së apelit, masa e sigurimit ndaj kërkueses, gjithsesi, është shuar për shkak të ligjit, ndërsa ajo ka marrë statusin e të dënuarës dhe tashmë qëndron në burgim dhe jo paraburgim, çka bën të pamundur lirimin e saj mbi shkakun e humbjes së fuqisë së paraburgimit në kuptim të nenit 263, paragrafi 3,

shkronja "c", të KPP-së, ndërkohë që periudha e paraburgimit përllogaritet në masën e dënimit që ajo duhet të shlyejë. Në këtë kuptim, gjykatat kanë konstatuar qëndrimin në paraburgim të kërkueses tej afatit ligjor 9-mujor të përcaktuar në dispozitën në fjalë, duke u shprehur edhe sa i përket mënyrës së rivendosjes së të drejtës të shkelur, pikërisht përmes llogaritjes, sipas përcaktimeve të nenit 57 të KP-së, edhe të kësaj periudhe paraburgimi në masën e dënimit që ajo duhet të vuajë.

20. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj, të cilat parashikohen në mënyrë të detajuar në KPP. Neni 27, pika 2, i Kushtetutës parashikon rastet e kufizimit të lirisë personale, ndërsa shkronja "a" e kësaj dispozite kushtetuese parashikon, ndër të tjera, kur individi është dënuar me burgim nga gjykata kompetente.

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor të masave të sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë e personit dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë *(shih vendimet nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 40, datë 18.7.2012; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

22. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) është shprehur në jurisprudencën e saj se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveç rasteve të parashikuara në nenin 5 të KEDNJ-së dhe vetëm bazuar në ligj (*shih vendimin e GJEDNJ-së Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar [DhM], nr. 13229/03, § 67, datë 28.1.2008*). Ajo i referohet edhe cilësisë së ligjit, i cili duhet të jetë në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës, mjaftueshëm i aksesueshëm, i saktë dhe i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që të shmanget çdo rrezik për arbitraritet (*shih vendimin e GJEDNJ-së Mooren kundër Gjermanisë [DhM], § 76, datë 9.7.2009*). Kështu, standardi i "ligjshmërisë" i vendosur nga Konventa kërkon që i gjithë ligji të jetë mjaft i saktë për t'i lejuar personit - nëse është e nevojshme, me këshillat e duhura – të parashikojë, në një shkallë që është e arsyeshme në rrethanat konkrete, pasojat e një veprimi të caktuar (*shih vendimet e GJEDNJ-së Grubic kundër Kroacisë, § 37, datë 30.10.2012; Steel dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 54, datë 23.9.1998*).

23. Dispozitat procedurale penale parashikojnë rregulla të hollësishme për revokimin, zëvendësimin ose shuarjen e masave të sigurimit, për kohëzgjatjen e paraburgimit dhe pezullimin e afateve të paraburgimit, të përmbledhura në kreun IV "Revokimi dhe shuarja e masave të sigurimit" të titullit V "Masat e sigurimit" të pjesës së parë të KPP-së. Kështu, neni 261 përcakton rastet kur masat e sigurimit shuhen, si dhe kompetencën e gjykatës për të vendosur mbi kërkesat për shuarjen e tyre brenda 48 orëve (pika 3). Neni 262 rregullon pasojat e shuarjes së masave të sigurimit, ku për sa i përket masës së arrestit, humbja e fuqisë së tij sjell si pasojë lirimin e menjëhershëm të personit nga gjykata. Më tej, neni 263 rregullon afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit gjatë hetimeve paraprake dhe gjatë gjykimit, specifikisht për gjykimin në shkallë të parë dhe për gjykimin në apel. Për sa i përket gjykimit në apel, afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit rregullohen në pikën 3 të këtij neni, ku në shkronjën "c" të të cilit përcaktohet: "*Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë kanë kaluar afatet e mëposhtme pa u dhënë vendimi i dënimit në gjykatën e apelit: ... c. Nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.*". Ndërkohë, neni 265 rregullon rastet e pezullimit nga gjykata të afateve të paraburgimit të parashikuara nga neni 263, për periudha të caktuara kohe.

24. Gjykata vëren se kërkuesja u është nënshtruar masave të sigurimit personal. Gjatë hetimeve paraprake, nën dyshimin për kryerjen e veprës penale "Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit", të parashikuar nga neni 136, paragrafi 2, i KP-së, ndaj saj është caktuar masa e sigurimit "Arresti në burg", masë e cila edhe është zbatuar. Sipas kësaj dispozite, vepra penale në fjalë dënohet në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim. Në përfundim të hetimeve paraprake kërkuesja është akuzuar për këtë vepër penale dhe çështja është dërguar për gjykim. Me vendimin nr. 1730, datë 20.5.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka deklaruar kërkuesen fajtore për veprën penale që akuzohej, duke e dënuar me 10 vjet burgim. Mbi ankimin edhe të kërkueses, çështja i ka kaluar për gjykim Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjatë shqyrtimit të

çështjes në apel, në seancën e datës 24.11.2016, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, kërkuesja, nëpërmjet mbrojtësit të saj, mbështetur në nenet 261, 262 dhe 263, të KPP-së, i ka kërkuar gjykatës së apelit të konstatojë humbjen e fuqisë së masës së sigurimit personal "Arresti në burg", me pretendimin se ndodhej në kushtet e pikës 3, shkronja "c", të nenit 263, të KPP-së, pasi nga data 20.5.2015, kur është dhënë vendimi i fajësisë nga gjykata e shkallës së parë dhe deri atë ditë (në datën 24.11.2016), kishin kaluar më shumë se 9 muaj (në fakt mbi 18 muaj) dhe gjykata e apelit ende nuk e kishte dhënë vendimin e saj.

25. Bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata konstaton se gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim kërkesën e kërkueses, duke çmuar të mos shprehej në atë moment procedural të gjykimit në lidhje me bazueshmërinë ose jo të saj, por të vijonte me shqyrtimin e çështjes, me arsyetimin se përgjigjja e kësaj kërkese varej nga përfundimi i gjykimit dhe zgjidhja në themel e çështjes. Gjykimi i çështjes ka përfunduar në të njëjtën seancë gjyqësore dhe gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në vendimin e saj, gjykata e apelit ka arsyetuar edhe për kërkesën e kërkueses për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal "Arresti në burg". Sipas gjykatës së apelit, ndonëse konstatimi i mbrojtjes së kërkueses është i vërtetë, në kushtet kur kjo kërkesë është paraqitur në të njëjtën ditë kur gjykohej çështja e themelit dhe kur ajo arrinte në përfundimin se vendimi i dënimit i gjykatës së shkallës së parë për kërkuesen duhet të lihej në fuqi, nuk ka shkak për zëvendësimin e masës së sigurimit "Arresti në burg" për sa kohë vendimi i saj është i formës së prerë dhe menjëherë i ekzekutueshëm (shih faqen 13 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë).

26. Arsyetimi i lartpërmendur i gjykatës së apelit është konsideruar i drejtë edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka argumentuar se me shpalljen e vendimit të formës së prerë, masat e sigurimit shuhen, për rrjedhojë masa e sigurimit për të cilën kërkohet shuarja, shuhet gjithsesi për këtë shkak të ri. Nga ana tjetër, ky kolegj ka arsyetuar se me shpalljen e vendimit të formës së prerë të dënimit me burgim, ky i fundit fillon menjëherë të prodhojë efekte, çka do të thotë se kërkuesja ka marrë statusin e të dënuarës dhe qëndron në burgim (jo më në paraburgim) për efekt të këtij vendimi, duke u bërë i pamundur lirimi për shkak të humbjes së fuqisë së paraburgimit, sipas parashikimeve të nenit 263, pika 3, të KPP-së. Kolegji Penal ka çmuar, gjithashtu, se qëndrimi në burg gjatë kohës së paraburgimit do të përllogaritet në masën e dënimit që duhet të shlyejë kërkuesja (*shih paragrafin 79 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

27. Nga sa më lart, Gjykata vëren se nga pikëpamja kushtetuese, pritshmëria legjitime e kërkueses në lidhje me kërkesën për humbjen e fuqisë së paraburgimit ka konsistuar në ndërprerjen e paraburgimit dhe lirimin e menjëhershëm të saj nga gjykata. Megjithatë, Gjykata konstaton se në të njëjtën ditë me atë të paraqitjes së kërkesës nga kërkuesja, pas shpalljes së vendimit nga gjykata e apelit, për shkak të dënimit të dhënë prej saj, masa e sigurimit "Arresti në burg" ndaj kërkueses ka humbur fuqinë, ndërkohë që heqja e lirisë për të ka vijuar tashmë në funksion të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë të dënimit. Nisur nga kjo, pavarësisht se gjykata e apelit nuk është shprehur veçmas në lidhje me kërkesën e kërkueses, por së bashku me vendimin përfundimtar dhe gjithsesi në të njëjtën ditë kur kërkesa është paraqitur, Gjykata vlerëson se kufizimi i lirisë së saj personale në vijim nuk rezulton e cenuar për sa kohë paraburgimi i saj ka përfunduar në kuptim të ligjit, duke vijuar heqja e lirisë për të (burgimi) mbi një tjetër shkak kushtetues, ai i dënimit me burgim.

28. Për periudhën e vuajtur të paraburgimit përpara paraqitjes së kërkesës nga kërkuesja për humbjen e fuqisë së masës së sigurimit, Gjykata vëren se gjykatat e zakonshme kanë njohur shkeljen e së drejtës kushtetuese të kërkueses. Ato kanë pranuar se kohëzgjatja e qëndrimit të saj në paraburgim, në pritje të shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit, ka kapërcyer afatin 9-mujor të përcaktuar nga neni 263, pika 3, shkronja "c", i KPP-së, në rrethanat kur gjykata e apelit nuk e ka dhënë vendimin e saj brenda këtij afati nga dita e dhënies së vendimit të dënimit për të nga gjykata e shkallës së parë, ndërkohë që nuk ka pasur disponime nga ana e saj për pezullimin e afatit 9-mujor të paraburgimit për ndonjë periudhë kohore të caktuar, çka, për rrjedhojë, çonte në humbjen e fuqisë së paraburgimit për kërkuesen. Ajo që vihet në diskutim në këtë rast është korrigjimi i shkeljes në momentin e paraqitjes së kërkesës. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se përfundimi si më lart nuk e klasifikon periudhën e paraburgimit në fjalë si

burgim të padrejtë në kuptim të nenit 268 e vijues të këtij kodi, vetëm për të cilin ligji i njeh personit të cenuar të drejtën e kompensimit. Nga ana tjetër, sikurse gjykatat e zakonshme janë shprehur, Gjykata vëren se korrigjimi i shkeljes në këtë rast bëhet nga ligji, i cili në kohën e dënimit të vuajtur nga kërkuesja përfshin të gjithë periudhën e paraburgimit. Kështu, neni 465 i KPP-së, që bën fjalë për llogaritjen edhe të paraburgimit, parashikon se në caktimin e kohës së dënimit me burgim, llogaritet edhe periudha e vuajtur e paraburgimit për të njëjtën vepër penale. Kurse neni 57 i KP-së përcakton se një ditë paraburgim është baras me një ditë e gjysmë burgim. Në këtë kuptim, periudha e paraburgimit e vuajtur nga kërkuesja në kapërcim të afatit të përcaktuar nga ligji procedural përfshihet në kohën e dënimit të vuajtur nga ajo, duke u llogaritur kjo periudhë njëlloj sikurse edhe periudha tjetër e paraburgimit. Kërkuesja nuk ka parashtruar ndonjë kundërshtim në këtë drejtim.

29. Gjithashtu, Gjykata nuk mund të mos evidentojë se, pavarësisht pretendimit për humbjen e fuqisë së masës së sigurimit prej disa muajsh, kërkuesja, në fakt, kërkesën e ka paraqitur vetëm në datën 24.11.2016, ditën e gjykimit të çështjes në themel nga gjykata e apelit. Ajo gjatë gjithë procesit gjyqësor është mbrojtur me avokat të zgjedhur prej saj, i cili për shkak të profesionit prezumohet të jetë i njohur me parashikimet e legjislacionit procedural penal, përveçse të ketë edhe aftësitë e nevojshme profesionale për të ndërmarrë çdo akt dhe veprim ligjor në funksion të mbrojtjes së të drejtave të kërkueses në këtë rast. Legjislacioni procedural penal, ndër të tjera, ka për detyrë të mbrojë lirinë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshëm të shtetasve, ku në funksion të kësaj, ndërsa, nga njëra anë, ngarkon me detyrime organet publike subjekte të procedimit penal, nga ana tjetër, u ka dhënë shtetasve mjetet e nevojshme ligjore për mbrojtjen e tyre, duke kërkuar në këtë kuptim edhe një aktivizëm nga ana e tyre.

30. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se ndonëse për kërkuesen ka pasur cenim të lirisë personale për shkak të tejzgjatjes së paraburgimit në pritje të gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit, një shkelje e tillë, e pranuar nga gjykatat e zakonshme, është korrigjuar nga vetë ligji, sikurse më lart u parashtrua. Për rrjedhojë, kërkesa e kërkueses për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme për shkak të cenimit të lirisë personale, është e pabazuar. Për më tepër, shkelja e së drejtës së kërkueses nuk i ka ardhur dhe nuk mund të vijë nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara prej saj, ndaj ajo nuk mund të përbëjë shkak për shfuqizimin e tyre.

31. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e lirisë personale është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

32. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të paraqitura në rekurs, të cilat kishin të bënin me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, të cilat ajo duhet t'i analizonte dhe jo të vendoste mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit.

33. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se ky pretendim nuk është i bazuar, pasi Gjykata e Lartë ka analizuar dhe kthyer përgjigje edhe për themelin e pretendimeve të kërkueses, duke vendosur mospranimin e rekursit për shkak të mungesës së shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Vendimi paraqitet i qartë, pa kundërthënie dhe pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e shkaqet e rekursit. Po ashtu, pjesa arsyetuese është në harmoni me konkluzionin se në rastin konkret nuk ka mosrespektim të ligjit penal nga gjykatat e faktit.

34. Në kuptim të nenit 42, pika 1, të Kushtetutës e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal *(shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

35. Gjykata ka theksuar qëndrimin e saj se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime, të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet

ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në shqyrtimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimin nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastet kur kërkuesi nuk ka marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, është konsideruar se cenohet jo vetëm standardi i arsyetimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pasqyruar në vendimin objekt kundërshtimi shkaqet e ngritura në rekursin e ushtruar nga kërkuesja, ndër të tjera, edhe ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga "Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit", të parashikuar nga neni 136 paragrafi 2, i KP-së, në "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 i KP-së, me pretendimin se nuk ekziston rrethana e bashkëpunimit me të pandehurin tjetër. Gjykata e Lartë, në referim edhe të vendimit unifikues nr. 4, datë 15.4.2011, të Kolegjeve të Bashkuara, i ka gjetur të pabazuara këto pretendime dhe ka arsyetuar se në rastin konkret plotësohen tërësisht elementet e bashkëpunimit, si nga ana objektive, pasi janë dy ose më shumë subjekte (pluralitet personash) dhe fakti kriminal është realizuar në të gjitha elementet e tij materiale, si nga elementet e anës subjektive, pasi kontributi i dhënë nga kërkuesja ka qenë rilevant për kryerjen e veprës penale, pasi ka krijuar kushtet për vjedhjen nga i pandehuri tjetër të parave për vite me radhë (*shih paragrafin 81 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Sipas asaj gjykate, shkaqet e paraqitura në rekurs nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e gjykatave të faktit; nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit penal nga këto gjykata; gjykatat nuk kanë bërë shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit apo shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit në dëm të kërkueses (*shih paragrafin 83 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për këto arsye, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses.

37. Në përputhje me standardet e evidentuara në jurisprudencën kushtetuese, Gjykata çmon se kërkuesja e ka ushtruar plotësisht të drejtën e saj për të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Megjithëse me një arsyetim të kufizuar, Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve të rekursit, duke arritur në përfundimin se nuk ekzistojnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Për më tepër, ajo gjykatë është ndalur dhe u ka kthyer përgjigje pretendimeve të kërkueses, veçanërisht atyre në drejtim të kualifikimit të veprës penale dhe institutit të bashkëpunimit, në interpretim të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara. Në këtë mënyrë, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk cenon standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, vetëm fakti që rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt, për sa kohë që Kolegji Penal ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij dhe me rregullat procedurale që gjejnë zbatim gjatë kësaj faze të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit është i pabazuar.

38. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e lirisë personale dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 13.11.2023.

Shpallur më 18.12.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj (pjesërisht kundër)

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

Anëtarë (pjesërisht kundër): Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkueses Mimoza Bruzia, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve nr. 1730, datë 20.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1522, datë 24.11.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-1513, datë 22.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", jemi pjesërisht kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësojmë se Gjykata duhet të vendoste konstatimin e cenimit të lirisë personale të parë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit. Në vijim do të parashtrojmë argumentet mbi të cilat mbështesim qëndrimin tonë.

2. Kushtetuta në nenin 27 ka parashikuar ndalimin për heqjen e lirisë, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. Ndërsa në lidhje me kufizimin e lirisë, kjo dispozitë ka parashikuar rastet ku kjo është e lejueshme nga pikëpamja kushtetuese, mes të tjerash: a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente; c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen e veprës penale ose largimin pas kryerjes së saj. Në nenin 28 të Kushtetutës janë parashikuar garancitë procedurale në rastet e heqjes së lirisë, ku përfshihet edhe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të pasur një gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose për t'u proceduar i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit.

3. E drejta e lirisë dhe sigurisë personale gjen mbrojtje edhe nga neni 5 i KEDNJ-së, në pikën 1 të të cilit parashikohet se askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj: a) kur burgoset ligjërisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente; c) kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj etj. Sipas GJEDNJ-së, për qëllime të nenit 5, pika 1, shkronja "a", të KEDNJ-së, fjala "dënim" nënkupton konstatimin e fajësisë, pas përcaktimit në përputhje me ligjin se është kryer një vepër penale, si dhe dhënien e dënimit ose të një mase tjetër që përfshin heqjen e lirisë (*shih Del Río Prada kundër Spanjës, nr. 42750/0, § 124, datë 21 tetor 2013*).

4. Në përputhje me delegimin kushtetues rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar në KPP. Dispozitat procedurale, përveç kushteve dhe kritereve për caktimin e masave të sigurimit kanë parashikuar edhe detyrimin që çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori të informojë me shkrim gjykatën që ka caktuar masën mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit. Kur prokurori nuk informon në afatin e përcaktuar, gjykata verifikon nevojat e sigurimit me kërkesë të të pandehurit ose kryesisht dhe pasi dëgjon palët, gjykata vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit (neni 246, pika 6, i KPP-së).

5. Duke iu kthyer çështjes konkrete, rezulton se, referuar akteve të kësaj çështjeje, kërkuesja është proceduar penalisht për kryerjen e veprës penale "Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit", të parashikuar nga neni 136, paragrafi 2, i KP-së. Mbi bazën e kërkesës së prokurorit, në datën 24.7.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka caktuar ndaj saj masën e sigurimit personal "Arresti në burg". Në vijim prokurori ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të kërkueses, e cila ka vijuar të qëndrojë nën masën e arrestit në burg edhe gjatë procesit gjyqësor në shkallë të parë. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 1730, datë 20.5.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka deklaruar fajtore kërkuesen për veprën penale për të cilën akuzohej, duke e dënuar atë me 10 vjet burgim. Ky vendim është ankimuar nga kërkuesja në gjykatën e apelit.

6. Gjatë gjykimit të çështjes së saj në gjykatën e apelit, konkretisht në seancën gjyqësore të datës 24.11.2016, kërkuesja ka kërkuar humbjen e fuqisë së masës së sigurimit "Arresti në burg", për arsye se bazuar në nenin 263, pika 3, shkronja "c" të KPP-së kanë kaluar afatet ligjore pa u dhënë vendimi në gjykatën e apelit. Në po këtë datë, gjykata e apelit ka marrë edhe vendimin për themelin e gjykimit, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për kërkuesen. Kundër vendimit kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila i ka konsideruar të drejta vendimet penale të gjykatave më të ulëta, dhe ka argumentuar se me shpalljen e vendimit të formës së prerë, masat e sigurimit shuhen, për rrjedhojë, masa e sigurimit është shuar gjithsesi për këtë shkak. Me shpalljen e vendimit të formës së prerë të dënimit me burgim, ky i fundit fillon menjëherë të prodhojë efekte, çka do të thotë se kërkuesja ka marrë statusin e të

dënuarës dhe qëndron në burgim (jo më në paraburgim) për efekt të këtij vendimi, duke u bërë i pamundur lirimi për shkak të humbjes së fuqisë së paraburgimit, sipas parashikimeve të nenit 263, pika 3 të KPP-së. Po sipas atij vendimi, qëndrimi në burg gjatë kohës së paraburgimit do të përllogaritet në masën e dënimit që duhet të shlyejë kërkuesja (*shih paragrafin 79 të vendimit të Gjykatës së Larte*).

7. Mbi bazën e rrethanave si më sipër, kërkuesja ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit, me pretendimin se kanë cenuar lirinë personale, në kundërshtim me nenin 27 të Kushtetutës, si edhe të drejtën për proces të rregullt. Shumica ka çmuar t'i analizojë pretendimet e kërkueses në drejtim të lirisë personale dhe së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

8. Për sa i përket pretendimit për cenimin e lirisë personale, shumica, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar se megjithëse kërkuesja ka pasur pritshmëri të ligjshme për t'u liruar për shkak të zgjatjes së paraburgimit përtej afatit ligjor, liria personale e saj nuk është cenuar për sa kohë ajo është dënuar me burgim. Sipas shumicës, shkelja (zgjatja e paraburgimit përtej afatit ligjor) është korrigjuar nga vet ligji, sepse periudha e paraburgimit përtej afatit ligjor llogaritet në kohën e dënimit të vuajtur nga kërkuesja. Në vijim, shumica ka evidentuar se kërkuesja gjatë procesit gjyqësor është mbrojtur me avokat të zgjedhur prej saj, i cili për shkak të profesionit prezumohet të jetë i njohur me parashikimet e legjislacionit procedural penal, përveçse të ketë dhe aftësitë e nevojshme profesionale për të ndërmarrë çdo akt dhe veprim ligjor në funksion të mbrojtjes së të drejtave të kërkueses në këtë rast. Për më tepër, legjislacioni procedural penal u ka dhënë shtetasve mjetet e nevojshme ligjore për mbrojtjen e tyre, duke kërkuar në këtë kuptim edhe një aktivizëm nga ana e tyre. Për rrjedhojë, sipas shumicës, shkelja e së drejtës së kërkueses nuk ka ardhur dhe nuk mund të vijë nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara prej saj, ndaj ajo nuk mund të përbëjë shkak për shfuqizimin e tyre (*shih paragrafët 27–30 të vendimit*).

9. Në vlerësimin tonë, duke mbajtur në konsideratë se kërkuesja ka kërkuar cenimin e *lirisë personale* pasi ka vijuar të qëndrojë në paraburgim në tejkalim të afatit 9-mujor të parashikuar nga neni 263, paragrafi 3, shkronja "c", i KPP-së, çmojmë se pretendimet e saj duhet të ishin vlerësuar në drejtim të kritereve kushtetuese të kufizimit të lirisë në kuptim të nenit 27 të Kushtetutës dhe garancive procedurale të nenit 28 të saj. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar jo vetëm rëndësinë që merr zbatimi i dispozitave procedurale penale në drejtim të respektimit të lirisë personale, por edhe detyrimin e organeve të pushtetit publik, sipas nenit 15 të Kushtetutës, për të respektuar të drejtën për proces të rregullt ligjor edhe ndaj personave, të cilëve sipas ligjit iu është kufizuar liria, pasi, ashtu si të drejtat e tjera, edhe kjo e drejtë është e pandashme, e patjetërsueshme dhe e padhunueshme. Në rastin individëve, liria e të cilëve është kufizuar sipas ligjit, organet e pushtetit publik kanë detyrime shtesë për të dëshmuar se të drejtat kushtetuese të tyre respektohen dhe, pikërisht për këtë arsye, nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës parashikojnë garanci specifike për këtë kategori individësh (*shih vendimin nr. 5, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, organet shtetërore (përfshi prokurorinë dhe gjykatat) kanë detyrimin t'i respektojnë këto të drejta dhe liri dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

10. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), është shprehur në jurisprudencën e saj se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveç rasteve të parashikuara në nenin 5 të KEDNJ-së dhe vetëm bazuar në ligj (*shih Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar [DhM], nr. 13229/03, § 67, datë 28 janar 2008*). Konventa në thelb i referohet legjislacionit të brendshëm dhe deklaron detyrimin për t'iu përshtatur rregullave materiale dhe procedurale, por gjithashtu çdo heqje lirie duhet të jetë në përputhje me qëllimin e nenit 5, pra të mbrojë individët nga arbitrariteti (*shih vendimet e GJEDNJ-së Bozano kundër Francës, datë 18.12.1986, paragrafi 54; Lukanov kundër Bullgarisë, datë 20.3.1997, paragrafi 41*).

11. Po sipas GJEDNJ-së, paraburgimi në çështjet penale kërkon intervale të shkurtra ndërmjet rishikimit të vendimeve (*shih Bezicheri kundër Italisë, 1989, § 21*). Nëse koha përpara marrjes së një vendimi është prima facie e papajtueshme me nocionin e shpejtësisë së gjykimit, Gjykata do të kërkojë nga shteti që të shpjegojë arsyen e vonesës ose të parashtrojë arsye të jashtëzakonshme për të justifikuar kalimin e kohës në fjalë (*shih Musiał kundër Polonisë [GC], 1999, § 44; Koendjbiharie kundër Holandës, 1990, § 29*). As ngarkesa e tepërt e punës dhe as periudha e pushimeve nuk mund të justifikojnë një periudhë pasiviteti nga ana e

autoriteteve gjyqësore (*shih E. kundër Norvegjisë, 1990, § 66; Bezicheri kundër Italisë, 1989, § 25*).

12. Siç kemi theksuar më sipër, kërkuesja përgjatë kohës që çështja ka qenë në fazën e hetimit dhe deri në dhënien e vendimit nga gjykata e apelit ka qenë nën masën e sigurimit personal "Arresti në burg". Sipas nenit 263, pika 3, të KPP-së, paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë kanë kaluar afatet e mëposhtme pa u dhënë vendimi i dënimit në gjykatën e apelit: c) nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm. Vendimi i dënimit për kërkuesen me burgim është dhënë në datën 20.5.2015, nga gjykata e shkallës së parë, dhe në datën 24.11.2016, kur është dhënë vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, kishte kaluar një periudhë prej 18 muajsh, pra ishte tejkaluar afati 9-mujor. Në Gjykatën e Apelit rezulton që çështja të jetë mbajtur pa veprime dhe është caktuar vetëm kjo seancë e datës 24.11.2016, ndonëse kërkuesja ndodhej nën masën e sigurimit "Arresti në burg".

13. Edhe pse kërkuesja nuk ka paraqitur kërkesë për shuarjen e kësaj mase pas kalimit të afatit ligjor, ashtu siç arsyeton shumica (*shih paragrafin 29 të vendimit*) dhe pavarësisht se në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se palët duhet të tregojnë kujdesin e duhur në përdorimin e mjeteve ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese e ligjore, në rastin konkret natyra e së drejtës që vihen në diskutim, që është ndalimi i kufizimit të lirisë personale nëse nuk plotësohen kërkesat ligjore, bënte të nevojshme trajtimin e kësaj çështjeje në këndvështrim të detyrimit të organeve shtetërore për zbatimin e parashikimeve të nenit 246, pika 6, të KPP-së dhe detyrimeve aktive të prokurorit dhe gjykatës, që shqyrtimi i çështjes në gjykatën e apelit të bëhej brenda afatit ligjor 9 mujor. Edhe pse gjykatat e zakonshme kanë konstatuar kalimin e afateve ligjore ato nuk janë shprehur as për veprimet e kryera nga prokuroria dhe vetë gjykatat për verifikimin e nevojave të sigurimit në rastin e kërkueses dhe as për shuarjen e masës së sigurimit, por kanë bazuar arsyetuar se me shpalljen e vendimit të formës së prerë të dënimit me burgim, ky i fundit fillon menjëherë të prodhojë efekte, çka do të thotë se kërkuesja ka marrë statusin e të dënuarës dhe qëndron në burgim (jo më në paraburgim) për efekt të këtij vendimi, duke u bërë i pamundur lirimi për shkak të humbjes së fuqisë së paraburgimit, sipas parashikimeve të nenit 263, pika 3 të KPP-së. Kolegji Penal ka çmuar, gjithashtu, se qëndrimi në burg gjatë kohës së paraburgimit do të përllogaritet në masën e dënimit që duhet të shlyejë kërkuesja.

14. Siç ka pranuar edhe shumica, në parim, legjislacioni procedural penal u ka dhënë shtetasve mjetet e nevojshme ligjore për mbrojtjen e tyre, duke kërkuar në këtë kuptim edhe një aktivizëm nga ana e tyre, në rastin në shqyrtim, për shkak se kërkuesja ndodhej në kushtet e izolimit, një aktivizëm të tillë e vlerësojmë barrë të tepruar për të. Për më tepër, në kushtet kur legjislacioni procedural ka parashikuar garanci të posaçme për personat ndaj të cilëve është vendosur një masë sigurimi personal, organet shtetërore duhet të luajnë një rol aktiv në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave kushtetuese të individëve, përfshi edhe kontrollin sistematik gjyqësor të kushteve të masës së sigurimit, për shkak të ndërhyrjes që ajo bën në lirinë personale të individit. Në këtë pikëpamje, me anë të këtyre procedurave, autoritetet gjyqësore kanë detyrimin që individit t'i garantojnë të gjitha standardet e duhura për mbrojtjen efektive në rastet e heqjes arbitrare të lirisë.

15. Në analizë të sa më lart, ne gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se pretendimi i kërkueses për cenimin e lirisë personale është i bazuar. Nga ana tjetër, vlerësojmë se mënyra se si e kanë trajtuar gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kërkesën e kërkueses dhe pretendimet e saj me natyrë kushtetuese, vë në dyshim edhe standardin e arsyetimit të atyre vendimeve.

16. Megjithatë, ashtu siç Gjykata ka mbajtur qëndrim edhe në raste të tjera (*shih vendimin nr. 5, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*), kur pavarësisht konstatimit të shkeljes së të drejtave themelore dërgimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk do të sillte ndonjë rezultat konkret për kërkuesin, në këtë rast për shkak se tashmë kufizimi i lirisë personale është pasojë e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të dënimit të formës së prerë, shumica duhet të shprehej vetëm për konstatimin e cenimit të lirisë personale.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci

VENDIM
Nr. 386, datë 30.11.2023

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR CAKTIMIN E PROCEDURËS DHE MASËS SË TRAJTIMIT FINANCIAR TË PROKURORIT PËR SHËRBIMIN NË SKEMËN E DELEGIMIT, PËR TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM, PËR CAKTIMIN E PËRKOHSHËM DHE CAKTIMIN PËR NJË ÇËSHTJE TË VEÇANTË"

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa "e", të Kushtetutës; në nenet 159, pika 2, shkronja "e", 188, pika 1, dhe 189, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar; në nenet 11, pika 3, germa "a", 12, 13/1, 15, 45, 46, 59 dhe 170/1, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; në nenin 40, të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; në nenin 56, të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 64, datë 15.4.2019, "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve", të ndryshuar; të vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 160, datë 8.7.2020, "Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit"; në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar; në udhëzimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", me propozim të grupit të punës, ngritur me urdhrin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 113, datë 21.6.2022, "Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e rregullores 'Për mënyrën e caktimit të kompensimit financiar që përfitojnë prokurorët që shërbejnë në skemën e delegimit, të transferuar përkohësisht ose të caktuar përkohësisht'", i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare *web* të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më 30.11.2023.

KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË
Alfred Balla

RREGULLORE
PËR CAKTIMIN E PROCEDURËS DHE MASËS SË TRAJTIMIT FINANCIAR TË PROKURORIT PËR SHËRBIMIN NË SKEMËN E DELEGIMIT, PËR TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM, PËR CAKTIMIN E PËRKOHSHËM DHE CAKTIMIN PËR NJË ÇËSHTJE TË VEÇANTË

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave më të detajuara dhe procedurës që duhet të ndiqet në prokurori, për kompensimin financiar të prokurorit, lidhur me shërbimin e tij në skemën e delegimit, gjatë transferimit të përkohshëm, caktimit të përkohshëm dhe caktimit për një çështje të veçantë, si dhe masën e kompensimit.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë prokurorët e skemës së delegimit, të transferuar përkohësisht, të caktuar përkohësisht apo të caktuar për hetimin e një çështjeje të veçantë, pranë Prokurorisë së Përgjithshme, prokurorive të shkallës së parë dhe të apelit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të

posaçëm, të cilëve nuk u është kufizuar ushtrimi i funksionit për shkaqe të parashikuara në ligj.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Skema e delegimit" është tërësia e rregullave të caktimit të prokurorit, nga prokuroria ku ai është i caktuar në mënyrë të përhershme, në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për një periudhë kohore të caktuar dhe të shërbimit të tij në funksion të kësaj skeme, për të hetuar çështje në çdo prokurori.

2. "Prokuror i transferuar përkohësisht" është prokurori i cili me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë transferohet për një periudhë të caktuar kohe, nga një pozicion i përhershëm në prokurorinë e tij, në një pozicion të përkohshëm të lirë, në një prokurori tjetër të të njëjtit nivel, sipas nenit 46, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. "Caktimi i përkohshëm i prokurorit", nënkupton caktimin e përkohshëm të një prokurori, në një prokurori tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin, me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas nenit 59, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

4. "Caktimi i prokurorit për një çështje të veçantë" nënkupton caktimin e një prokurori me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për hetimin ose përfaqësimin në gjykatë të një ose disa çështjeve të veçanta, në një prokurori tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, sipas nenit 170/1, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

5. "Paga bruto fillestare", në kuptim të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përfaqëson pagën referuese bazë dhe shtesën e pagës në grup, sipas grupeve të pagave (G1, G2, G3), në prokurorinë ku prokurori është i caktuar në mënyrë të përhershme.

6. "Prokuror në skemë delegimi" është prokurori i caktuar në një pozicion në skemën e delegimit të krijuar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për të hetuar çështje penale në çdo prokurori.

7. "Prokuror në skemë delegimi pranë prokurorisë së posaçme" është prokurori i skemës së delegimit i cili përmbush kriteret dhe kushtet e sigurisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", të ndryshuar, i caktuar për të shërbyer pranë prokurorisë së posaçme.

8. "Prokuror në skemë delegimi, i caktuar për një çështje të veçantë pranë prokurorisë së posaçme", është prokurori i skemës së delegimit i cili me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është caktuar për të hetuar një çështje të veçantë pranë prokurorisë së posaçme.

9. "Trajtim financiar" është shtesa mbi pagë dhe kompensimi për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, caktimin e përkohshëm ose caktimin për një çështje të veçantë.

10. "Ditë" për qëllime të këtij udhëzimi konsiderohen ditë pune.

11. "Territor" konsiderohet njësia administrative / bashkia ku ndodhet prokuroria, ku prokurori është i caktuar në mënyrë të përhershme në pozicion ose territori i vendbanimit të tij të përhershëm.

12. "Këshill" është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Neni 4
Shtesa e pagës për prokurorët në skemë delegimi dhe ata të caktuar për çështje gjyqësore të veçanta, që nuk janë pjesë e kësaj skeme

1. Prokurori në skemë delegimi, i caktuar me vendim të Këshillit, përfiton 10 për qind shtesë page mbi pagën bruto fillestare. Kjo shtesë paguhet në prokurorinë ku është i caktuar në mënyrë të përhershme, me përjashtim të rasteve kur Këshilli me vendim vendos ndryshe.

2. Prokurori në skemë delegimi, i caktuar nga Këshilli pranë Prokurorisë së Posaçme, përfiton për vështirësi shtesë page në masën 80 për qind mbi pagën bruto fillestare. Kjo shtesë page paguhet nga prokuroria ku është i caktuar në mënyrë të përhershme, për gjithë periudhën e ushtrimit të shërbimit pranë skemës së delegimit, me përjashtim të rasteve kur Këshilli me vendim vendos ndryshe.

3. Prokurori i cili caktohet nga Këshilli për çështje të veçanta pranë Prokurorisë së Posaçme,

përfiton për vështirësi shtesë page në masën 40 për qind mbi pagën bruto fillestare. Kjo shtesë page paguhet nga prokuroria ku është i caktuar në mënyrë të përhershme dhe llogaritet në raport me ditët kur prokurori ka kryer veprime hetimore ose ka përfaqësuar çështje në gjykatë, për llogari të Prokurorisë së Posaçme.

Neni 5

Mënyra e kompensimit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm të prokurorit dhe për caktimin për një çështje të veçantë

1. Prokurori në skemën e delegimit, i transferuar apo caktuar përkohësisht, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, të shkallës së parë dhe apelit, për jo më shumë se njëzet e dy ditë pune, përfiton kompensim financiar për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit, shpenzimeve të transportit, si dhe dietë ditore për çdo ditë të ushtrimit të funksionit pranë prokurorisë ku delegohet, transferohet përkohësisht ose caktohet përkohësisht.

2. Prokurori në skemën e delegimit, i transferuar apo caktuar përkohësisht, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, të shkallës së parë dhe apelit, për një periudhë kohore më të gjatë se njëzet e dy ditë, përfiton një kompensim mujor në masën 80 për qind të pagës referuese bazë. Ky kompensim mbulon çdo shpenzim për qëndrimin dhe transportin e prokurorit në prokurorinë ku prokurori është deleguar, transferuar apo caktuar përkohësisht.

3. Prokurori i caktuar për një çështje të veçantë, në një prokurori tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, përfiton kompensim financiar për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit, shpenzimeve të transportit, si dhe dietë ditore për çdo ditë të ushtrimit të funksionit pranë prokurorisë ku caktohet, por jo kompensim mujor financiar në masën 80 për qind të pagës referuese bazë.

4. Shpenzimet e transportit llogariten në bazë të distancës më të shkurtër që rezulton ndërmjet prokurorisë ku ai delegohet, transferohet përkohësisht, caktohet përkohësisht apo caktohet për një çështje të veçantë, me prokurorinë ku ai është i caktuar në mënyrë të përhershme në pozicion ose me vendbanimin e tij të përhershëm.

5. Prokurori nuk përfiton kompensim financiar, sipas kësaj rregulloreje, në rastet kur prokuroria ku ai delegohet, transferohet përkohësisht, caktohet përkohësisht apo caktohet për një çështje të veçantë, ndodhet në të njëjtin territor me prokurorinë ku ai është i caktuar në mënyrë të përhershme në pozicion ose në territorin e vendbanimit të tij të përhershëm.

Neni 6

Procedura për miratimin dhe kompensimin për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm të prokurorit dhe për caktimin për një çështje të veçantë

1. Prokurori përfitues, sipas pikave 1 dhe 3, të nenit 5 të kësaj rregulloreje, paraqet dokumentacionin vërtetues justifikues, lidhur me shpenzimet e kryera për qëndrimin, transportin dhe dietën ditore, për çdo ditë të ushtrimit të funksionit pranë prokurorisë ku delegohet, transferohet përkohësisht, caktohet përkohësisht apo caktohet për një çështje të veçantë, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar.

2. Prokurori përfitues, sipas pikës 2, të nenit 5 të kësaj rregulloreje, kur delegohet, transferohet përkohësisht, caktohet përkohësisht për një periudhë kohore më të gjatë se njëzet e dy ditë, kompensohet financiarisht për çdo muaj në vlerën 80 për qind të pagës referuese bazë.

3. Kompensimi financiar realizohet pas nxjerrjes së urdhrit nga drejtuesi i prokurorisë, në të cilën përcaktohet prokurori përfitues, periudha si dhe masa e kompensimit financiar. Urdhri mbështetet në dokumentacionin justifikues vërtetues, si më poshtë:

a) Kërkesën e bërë me shkrim nga prokurori në skemë delegimi, i transferuar përkohësisht, i caktuar përkohësisht apo i caktuar për një çështje të veçantë lidhur me kompensimin;

b) Vendimin e Këshillit mbi caktimin në skemën e delegimit, transferimin e përkohshëm, caktimin e përkohshëm apo caktimin për një çështje të veçantë;

c) Vërtetimin e vendbanimit të tij të përhershëm;

ç) Dokumentacionin justifikues vërtetues, sipas pikave 1 dhe 3, të nenit 5 të kësaj rregulloreje, për rastet jo më shumë se 22 ditë pune.

4. Mosparaqitja e dokumentacionit të përcaktuar në pikën e mësipërme të këtij udhëzimi përbën shkak për moskryerjen e pagesës.

Neni 7
Buxheti dhe zbatimi

1. Trajtimi financiar për prokurorët sipas përcaktimeve të mësipërme përballohet nga fondet buxhetore nga prokuroria në të cilën prokurori është caktuar në mënyrë të përhershme, përveçse në rastet kur është vendosur ndryshe nga Këshilli.

2. Programimi i fondeve buxhetore të nevojshme për shpenzimet e trajtimit financiar si pasojë e zbatimit të kësaj rregulloreje bëhet nga secila prokurori, gjatë procesit të hartimit të projektbuxhetit, për çdo vit buxhetor.

3. Ngarkohen prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, të shkallës së parë dhe të apelit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme, për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 8
Dispozita kalimtare

1. Prokurori në skemën e delegimit, i transferuar përkohësisht, i caktuar përkohësisht apo i caktuar për një çështje të veçantë, që ka shërbyer si më sipër përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, trajtohet financiarisht sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 50/2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'", i ndryshuar, përveç rasteve kur Këshilli me vendim ka përcaktuar masën e trajtimit financiar.

2. Kur prokuroria pranë së cilës ka qenë i caktuar në mënyrë të përhershme prokurori i transferuar përkohësisht, i caktuar përkohësisht apo i caktuar për një çështje të veçantë ka ndërprerë veprimtarinë për shkak të riorganizimit, trajtimi financiar do të përballohet nga prokuroria pranë së cilës prokurori është transferuar pas riorganizimit.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 188
Datë: 2023/12/26 15:59:07
0b30d1bb-f706-4f86-a1c4-fdd228ce3ca1

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 480 lekë